



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 206 Akti

Nr. 288 Vendimi
Tiranë, më 6.8.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, në Tiranë, në datën 5.8.2020 ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petrit Çomo**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjo i subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, vëzhguesin ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Petrit Çomo, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, ushtron detyrën e gjyqtarit/kryetarit të gjykatës, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr 1, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Olsi Komici.

Me vendimin nr.1, datë 22.11.2018, trupi gjyqësor vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Petrit Çomo, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjyqësor, komisioneren Brunilda Bekteshi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt është caktuar znj. Mia Roessingh.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Grupi i punës në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.

Trupi gjyqësor, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 30.6.2020 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, si dhe njoftimin e tij për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 30.6.2020 u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përftuara nga hetimi kryesisht i Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjyqësor.

Subjekti i rivlerësimit, pas marrjes së njoftimit mbi rezultatet e hetimit në datën 7.7.2020, me anë të postës elektronike njofton Komisionin, duke kërkuar shtyrje të afatit për përgatitjen e mbrojtjes, paraqitjen e prapësimeve dhe provave mbi rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni, me arsyen e ngarkesës së madhe në punë për shkak të komandimi të tij si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioni, pas miratimit të kërkesës së subjektit, i njoftoi afatin e ri për kthimin e përgjigjeve dhe depozitim të provave mbi rezultatet e hetimit deri në datën 17.7.2020.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 14.7.2020, me anë të postës elektronike, ka kërkuar nga Komisioni shtyrjen sërish të afatit për dërgimin e provave dhe prapësimeve, pasi nuk ka mundur të sigurojë të gjitha provat e nevojshme.

Komisioni, pasi shqyrtoi edhe një herë kërkesën për shtyrje të afatit të subjektit të rivlerësimit, vendosi t'i japë një afat të ri, deri në datën 27.7.2020.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 27.7.2020 ka dërguar nëpërmjet postës elektronike prapësimet, si dhe provat për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 29.7.2020.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 5.8.2020, ora 9:30, në sallën e konferencave në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, ku parashtrroi shpjegimet e tij dhe i depozitoi me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit z. Petrit Çomo, kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Petrit Çomo ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit

përfshin të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. ***, datë 14.11.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çomo, i cili është subjekt deklarues pranë këtij institucionin që prej vitit 2003, me numër indeksi ***, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca ***, në datën 25.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr.

84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca ***, në zbatim të nenit 31/1¹, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca *.**

1. Banesë me sip. 122.9 m², Rr. “**” (tashmë ***), ***, ap. ***, Tiranë. Deklaruar në deklarimin fillestar si e peregjistruar. Regjistruar me kontratën e datës 9.3.2012² me certifikatë pronësie³, me vlerë 50,000 USD (ose 7,000,000 lekë) në momentin e ndërtimit. Sipas çmimeve të përcaktuara me VKM, zona ***.**

Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burim krijimi. Vlera: 23,351,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi administrativ i fakteve dhe rrethanave

Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003 subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi 2+1 me sip. 122 m², me kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 23.11.1999, me vlerë 7 milionë lekë. Pjesa 100% me burim krijimi - trashëgim nga babai*”.

Në deklaratën periodike të pasurisë (në vazhdim DIPP) të vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “*Regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë i banesës së deklaruar më parë (si e peregjistruar) me adresë Rr. “****” (***) , pallat ***-katësh, ap. ***, Tiranë, me sip. 122.9 m². Regjistruar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012, në vlerën 50,000 USD ose 7,000,000 lekë në momentin e ndërtimit. Pjesa takuese: 100%. Certifikatë pronësie datë 2.2.2012*”.

Subjekti ka depozituar kontratën e dhurimit, datë 9.3.2012⁴, me palë dhuruese shtetasit I.T., dhe A.Sh., dhe pranues i dhurimit shtetasi Petrit Çomo, me objekt dhurimi i apartamentit nr. ***, me sip. 122.9 m², kati ***, në godinën ***, rr. “****”, Tiranë.

ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana-Jug konfirmon pronësinë në emër të shtetasit Petrit Çomo për pasurinë “apartament” me sip. 122.90 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me adresë rr. “****”, Tiranë, të përfituar nga kontrata e dhurimit, datë 9.3.2012⁵.

Komisioni ka konstatuar dhe i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit në pyetësin nr. 2, në lidhje me: (i) nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*; (ii) nuk ka depozituar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.1999, me të cilën ka

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

² Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012.

³ Certifikatë pronësie nr. ***, datë 19.3.2012, z. k. ***, vol. ***, f. ***, pasuria nr. ***.

⁴ Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012.

⁵ Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012.

përfitur fillimisht këtë apartament, të pasqyruar në deklaratën për herë të parë të pasurisë të vitit 2003; (iii) nuk ka depozituar dokumentacion provues ligjor për burimin e krijimit të kësaj pasurie të deklaruar në vitin 2003 si “trashëgimi nga babai”; (iv) ka mospërputhje ndërmjet deklarimeve të subjektit, ndër vite, dhe dokumentacionit të depozituar në lidhje me mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti, pasi subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës (2003) deklaroi kontratë sipërmarrjeje, datë 23.11.1999, me vlerë 7.000.000 lekë, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* deklaroi vlerën 50,000 USD (ose 7,000,000 lekë), në kohën e ndërtimit, ndërkohë që për këtë apartament ka depozituar kontratën e dhurimit të datës 9.3.2012.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *“Në fillim të vitit 1992 ..., për shkak të persekutimit politik, pushteti vendor i kohës na strehoi në një godinë (vilë) pronë shtetërore e cila ndodhej në Rr. ‘***’, nr. ***, Tiranë, bashkë me disa familje të tjera... Pas disa kohësh me vendim të KKK Pronave të kohës godina dhe trualli iu kthyen ish-pronarëve dhe në këto kushte ne u kthyem qiramarrës në godina shtetërore ish-pronë private...Mbah mend se babai para se të vdiste (ka vdekur në janar të vitit 1998), si dhe banorët e tjerë të godinës kishin biseduar me ndërmjetës të ndryshëm që krahas pjesës që do merrte pronari i truallit, të merrnim edhe neve banesë nëse do të ndërtohej pallati... Shoqëria ‘***’ sh.p.k. bisedoi me pronarët dhe lidhi marrëveshje me ta për ndërtimin e një pallati në truallin ku ishte godina ku banonim ne... shoqëria ndërtuese mori përsipër edhe strehimin tonë pas ndërtimit të pallatit. Me secilën familje të godinës ku banonim dhe ne u arrit marrëveshja për strehim. Meqë babai kishte vdekur, me bisedimet me firmën ndërtuese u mora unë...I propozova shoqërisë që dorëzimi i banesës nga ana jonë të konsiderohej sikur ne kishim prenotuar një apartament në pallatin që do ndërtohej, siç bënin dhe persona të tjerë, pra, dorëzimi i banesës të konsiderohej sikur kishim paguar paratë që paguanin persona të tjerë që përpara se të ndërtohej pallati për të blerë apartamente me çmime më të mira. Pra, dorëzimi i banesës të konsiderohej si pagesë parash për prenotim banese. Shoqëria ndërtuese pranoi këtë propozim dhe nënshkruam te noteri kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.1999, dhe deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.1999.*

*Apartamenti i ri më është dorëzuar në vitin 2003, i ndodhur në katin e ***, fillimisht me nr. *** më pas ka nr. ***. Nuk mora certifikatën e pronësisë, pasi pallati nuk ishte i regjistruar në ZVRPP, por unë mund ta përdorja. Nuk kam banuar te ky apartament, pasi e kam dhënë me qira siç e kam deklaruar edhe në deklaratimet e pasurive. Pallati u regjistrua vite më vonë dhe kalimi i pronësisë nga shoqëria ndërtuese tek unë u bë me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012. Me sa di unë me kontratë tip dhurimi si kontrata që përmenda, iu kalua pasuria edhe familjeve të tjera të cilat banonin si ne tek ish-godina. Pra, qëllimi i kësaj kontrate ishte kalimi i apartamentit në pronësinë time për arsye të liritimit dhe dorëzimit të banesës ku ne banonim si qiramarrës. Njohja me shtetasit I.T., dhe A.Sh., ka ardhur për shkak të bisedimeve që kemi bërë marrëveshjen për lirim e banesës me qëllim për marrjen e një apartamenti tek pallati që do ndërtohej. Më përpara nuk kam pasur njohje personale me këta persona...”*

Subjekti ka depozituar kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.1999, lidhur ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k. dhe porositësit Petrit Çomo, për ndërtimin e apartamentit me sipërfaqe 107 m², kati ***, nr. ***, me adresë: rr. “***”, nr. ***, Tiranë.

Në nenin 2 të kontratës së sipërmarrjes është përcaktuar se: *“Palët bien dakord që në fillim që të shfuqizohet aktmarrëveshja e datës 20.7.1999, për sa i përket kalimit të pronësisë pa shpërblim. Për apartamentin objekt i kësaj kontrate të përcaktojë vlerën e tij, ambienti i banimit do të jetë 107 m² me çmim total 53,000 USD. Kësti i parë prej 45,000 USD paguhet në momentin e lidhjes*

së kësaj kontrate, kësti i dytë prej 8000 USD do të paguhet në momentin e dorëzimit të apartamentit”.

Në fund të kontratës specifikohet se kësti i parë prej 45,000 USD u pagua nga porositësi në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

Subjekti, gjithashtu, ka depozituar edhe deklaratën noteriale të datës 7.1.2020 lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., ku administratori i saj z. I.T., ka shpjeguar situatën e përfitimit të apartamentit nga subjekti Petrit Çomo, duke dhënë të njëjtat deklarime me ato të dhëna nga subjekti.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje në lidhje me sipërfaqen e apartamentit, pasi në kontratën e sipërmarrjes, datë 23.11.1999, është pasqyruar sipërfaqja 107 m², ndërsa në kontratën e dhurimit, datë 9.3.2012, sipërfaqja 122.9 m², pa specifikime të tjera në të dyja rastet.

Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka shpjeguar se: “...është shënuar sipërfaqja e apartamentit 107 m², sipas projektit në bazë të të cilit ishte dhënë leja e sheshit dhe e ndërtimit... Më pas projekti ndryshoi pak, sipërfaqet e apartamenteve duke përfshirë dhe sipërfaqen e përbashkët, u bënë pak më të mëdha... Sipas këtij regjistrimi dhe matjeve të sakta, rezulton që sipërfaqja e apartamentit ishte 122.9 m²”.

Komisioni ka konstatuar se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti në ILDKPKI është depozituar dhe një dokument “njoftim” dërguar nga shoqëria “****” sh.p.k., datë 6.12.2008, ku i kërkon subjektit shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura në shumën 6,650 euro që përfshijnë, këstin e fundit, pagesa shtesë që ka bërë kompania për legalizimin e objektit, si dhe ndryshimet në kursin e dollarit.

Subjekti ka shpjeguar se: “...mendoj se ka qenë njoftim tip për të gjithë personat që kishin prenotuar apartamente, por jam i sigurt që kemi biseduar përpara kontratës së dhurimit me pronarët e shoqërisë dhe kemi rënë dakord me mirëkuptim që detyrimet e ndërsjella të shuheshin, pasi kompensojnë njëra-tjetrën, si dhe të nënshkruanim kontratën e dhurimit për kalimin e pronësisë. Të dy palët nuk kanë pasur dhe nuk kanë as sot asnjë lloj pretendimi për të gjithë hapat dhe procedurat që janë ndjekur nga dorëzimi i apartamentit të vjetër deri në marrjen e apartamentit të ri”.

Komisioni ka hetuar edhe çështjen e konfliktit të interesit të subjektit Petrit Çomo me shoqërinë “****” sh.p.k., z. I.T., më shoqërinë “****” sh.p.k., z. A.Sh., shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shoqërinë “****” sh.p.k.. Nga korrespondenca me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶ janë vënë në dispozicion të Komisionit vendime gjyqësore që subjektet e lartpërmendur kanë pasur në këtë gjykatë. Nga verifikimi i vendimeve nuk ka rezultuar që këto të jenë gjykuar nga subjekti Petrit Çomo, duke mos u konstatuar asnjë situatë konflikti interesi e subjektit të rivlerësimit me subjektet e mësipërme.

Pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, si vijon:

- nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie;
- ka mospërputhje deklarimi në lidhje me burimin e deklaruar për përfitimin e apartamentit me sip.122.9 m², pasi në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 subjekti ka deklaruar si burim trashëgim

⁶ Shkresë nr. **** prot, datë 8.1.2020, nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

nga babai, kurse në DIPP të vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* rezulton se apartamenti është përfituar nëpërmjet dhurimit;

- ka mospërputhje ndërmjet deklarimeve të subjektit në deklaratat e pasurisë të viteve 2003, 2012 dhe në deklaratën *Vetting*, të dhënave në dokumentet e depozituara nga subjekti në ILDKPKI, si dhe përgjigjeve në pyetësorë, në lidhje me arsyen dhe mënyrën e përfitimit të pronësisë (me ose pa kundërshtëpërblim), të cilat duket se janë edhe kontradiktore për arsyet, si vijon:
 - i) subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor që të ketë banuar me qira në një apartament, pjesë përbërëse e një godine ***-katëshe e cila të jetë prishur më vonë me qëllim ndërtimin e një pallati nga shoqëria “****” sh.p.k.;
 - ii) në deklaratën e pasurisë për herë të parë të vitit 2003 subjekti deklaroi: “*Apartament banimi 2+1 me sip. 122 m², me kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.1999, me vlerë 7 milionë lekë*”;
 - iii) në DIPP të vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* deklaroi: “*Banesë e sip. 122.9 m², rr. “****” (tashmë ***), ***, ap. ***, Tiranë, deklaruar në deklarinimin fillestar si e paregjistruar. Regjistruar me kontratën e datës 9.3.2012⁷ (dhurim), me vlerë 50,000 USD (ose 7,000,000 lekë) në momentin e ndërtimit*”;
 - iv) në aktmarrëveshjen e datës 20.7.1999 të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit specifikohet se shoqëria, në pallatin që do të ndërtojë në truallin me sipërfaqe 1.300 m² në pronësi të bashkëpronarëve E., truall mbi të cilin ndodhet edhe një godine ***-katëshe ku banon z. Petrit Çomo, do të kalojë në pronësi të tij një apartament me sip. 90 m² pa shpërblim;
 - v) kontrata e sipërmarrjes e datës 23.11.1999 shfuqizon aktmarrëveshjen e datës 27.9.1999, nenin 2, për kalimin e pronësisë pa shpërblim dhe përcakton se çmimi i apartamentit (ku është përcaktuar vetëm sip. *neto* prej 107 m²) me sip. 107 m² do të jetë 53,000 USD, ku 45,000 USD do të paguhet në momentin e lidhjes së kontratës (u paguan me firmosjen e kontratës), ndërsa 8,000 USD në momentin e dorëzimit të apartamentit;
 - vi) kontrata e dhurimit, datë 9.3.2012, pasqyron dhurimin e apartamentit me sip. 122.9 m² nga I.T., dhe A.Sh., në cilësinë e investitorit Petrit Çomo;
 - vii) fakti që apartamenti është përfituar nga subjekti përkundrajt pagesës së një çmimi, përforcohet edhe nga dokument i depozituar nga subjekti në ILDKPKI, i llojit “njoftim”, i dërguar nga shoqëria “****” sh.p.k., datë 6.12.2008, ku i kërkon subjektit shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura në shumën 6,650 euro që përfshijnë, këstin e fundit, pagesa shtesë që ka bërë kompania për legalizimin e objektit dhe ndryshimit të kursit të dollarit, ndërkohë që nga subjekti është deklaruar se ato janë janë detyrime të ndërsjella që shuheshin me njëra-tjetrën, por pa specifikuar se cilat ishin këto detyrime të ndërsjella;
 - viii) ka mospërputhje faktesh midis deklaramit për mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti kur është deklaruar se: “*...shoqëria *** sh.p.k. bisedoi me pronarët dhe lidhi marrëveshje me ta për ndërtimin e një pallati në truallin ku ishte godina ku banonim ne... shoqëria ndërtuese mori përsipër edhe strehimin tonë pas ndërtimit të pallatit... Pra, dorëzimi i banesës të konsiderohej si pagesë parash për prenotim banese*”, me parashikimet e kontratës së sipërmarrjes së datës 23.11.1999 ku përcakton çmimin e këtij apartamenti, si dhe mënyrën e likuidimit të tij.

⁷ Kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012.

ix) ka mungesë të aktit ligjor të revokimit të kontratës të sipërmarrjes së datës 23.11.1999 meqenëse në vitin 2012 është lidhur kontrata e dhurimit për të njëjtin apartament.

x) ka mungesë deklarimi në DIPP të vitit 2008 të shumës 6,650 euro si detyrim ndaj shoqërisë “****” sh.p.k.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

- burimi i krijimit të kësaj pasurie është deklaruar saktësisht dhe me vërtetësi në deklaratën *Vetting*, që është kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012, e cila është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë. Pra, burimi i krijimit është dhurimi, një marrëdhënie pa kundërshtpërblim. Edhe në procesverbalin e datës 3.2.2015, mbajtur në ILDKPKI, subjekti thekson se apartamenti është fituar pa kundërshtpërblim pasi jemi trajtuar njësoj si pronarët e truallit të gjitha familjet që banonin aty;
- për të provuar marrëdhënien e qirasë në një apartament, pjesë përbërëse e godinës ***-katëshe e cila është prishur më vonë për t’u ndërtuar godina nga shoqëria “****”, subjekti ka depozituar si prova:(i) autorizimin e datës 28.09.1991 të Komitetit Ekzekutiv Pluralist⁸; (ii) akti i dhënies dhe i marrjes në dorëzim të banesës shtetërore në datën 28.2.1992; (iii) librezat e ujit për banesën me qira në rr. “****”, Vila ***;
- në lidhje me deklarinimin në vitin 2003 për apartamentin me sip. 122 m² deklaruar me vlerë 7.000.000 lekë, deklaratën e vitit 2012 ku apartamenti me sip. 122 m² deklarohet regjistruar me kontratën e dhurimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se meqenëse ish-pronarët⁹ përfshirë dhe nënën e tij, znj. L.B., nuk kanë qenë dakord me vendimin nr. 559, datë 20.7.1994, “Për kthimin dhe kompesimin e pronave”, të Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave ish-pronarëve (KKKP), pasi cenoheshin interesat e tyre të ligjshme, kanë paraqitur padi në gjykatë ku është zhvilluar procesi gjyqësor me palë: paditës: Prokuroria e Rrethit Tiranë dhe shtetasit P.R., H.Q., L.B.,¹⁰ A.P., G.R., dhe G.V.; i paditur: KKKP ish-pronarëve Bashkia Tiranë; persona të tretë: shtetasit A.E., E., dhe K.E.; objekt: anulimi i vendimit të KKKP-së. Duke qenë se çështja u zgjidh me pajtim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3038, datë 22.10.1999, vendosi: “*Miratimin e zgjidhjes së çështjes me pajtim midis paditësve dhe personave të tretë si më poshtë: Paditësit i njohin personat e tretë si ish-pronarë mbi banesën e tyre. Paditësit dhe personat e tretë kanë rënë dakord me firmën private “****” sh.p.k., që banesa ku banojnë paditësit të shembet duke u ndërtuar nga sipërmarrësi një ndërtesë shumëkatëshe ku do të sistemohen dhe paditësit.*” Subjekti deklaron se nga ky vendim rezulton se paditësit, ku bën pjesë dhe nëna e tij, kanë rënë dakord që do të merrnin pa kundërshtpërblim një apartament nga shoqëria “****” sh.p.k., në këmbim të liritimit të banesës së marrë me qira që prej vitit 1991;
- lidhur me aktmarrëveshjen e datës 20.7.1999, të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe z. Petrit Çomos, ku do të kalojë në pronësi të Petrit Çomos një apartament me sip. 90 m² pa shpërblim, subjekti ka depozituar si provë dhe aktmarrëveshjen e datës 20.7.1999, ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasit P.R. Në këtë aktmarrëveshje

⁸ ku thuhet shprehimisht: “*Me vendim të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Përkohshëm të Rrethit nr. ***, datë 24.9.1991, i jepet znj. L.B., një apartament me dy dhoma dhe një kuzhinë, në rrugën ‘****’, vila ‘****’.*”

⁹ Ish- pronarët P.R., H.Q., L.B., A.P., G.R., G.V.

¹⁰ Fillimisht kam qënë unë paditës, por më pas me kërkesë të nënës time të ndjerës L.B., është bërë zëvendësimi procedural duke qënë se ishte ajo që figuronte si qiramarrëse në kontratë.

thuhet shprehimisht se: “Shoqëria ‘***’ sh.p.k. merr përsipër që nga pallati që do të ndërtohej prej saj në truallin e mësipërm t’i kalojë në pronësi të z. P.R., një apartament me sip. 90 m² pa shpërblim. Z. P.R., është dakord të largohet nga banesa e tij për të lejuar shembjen e godinës ku ai banon. ...Apartamentin e premtuar në këtë aktmarrëveshje shoqëria ‘***’ shp.k. ia kalon z. P.R., nga pjesa e tij dhe jo nga detyrimet që ka ndaj pronarëve të truallit”. Subjekti shpjegon se e njëjta situatë është edhe në aktmarrëveshjen e datë 20.7.1999 të lidhur mes tij dhe shoqërisë, gjithashtu, si nga marrëveshjet me shkrim edhe nga vendimi nr. ***, datë 22.10.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton qartësisht se vullneti ka qenë që në cilësinë e qiramarrësve do të përfitonin apartamente pa shpërblim. Kjo ka qenë një praktikë e ndjekur me të gjithë qiramarrësit që liruan banesat për ndërtim dhe jo vetëm me familjen e subjektit;

- lidhur me kontratën e dhurimit, datë 9.3.2012, ku pasqyrohet dhurimi i apartamentit me sip. 122.9 m², subjekti ka theksuar faktin që është fituar me dhurim pa shpërblim, kjo provohet edhe me deklaratën e lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k., përfaqësuar nga z. I.T., i cili ka deklaruar marrëveshjen për ndërtimin e pallatit në truallin ku ndodhej një banesë në Rr. “***”, me pronarët e truallit, si dhe pronarët e godinës ***-katëshe mbi këtë truall, ku pas bisedimeve përfshirë dhe subjektin Petrit Çomo ata do të lironin banesat kundrejt shpërblimit në të holla apo marrjes së një apartamenti në pallatin që do të ndërtohej. Përfaqësuesi I.T., ka deklaruar... *se kujton që shoqëria ka nënshkruar disa marrëveshje apo kontrata. Marrëdhënia me z. Petrit Çomo ka përfunduar me nënshkrimin e kontratës së dhurimit nr. ***, datë 9.3.2012, me anë të së cilës i kaloi pronësia shtetasit Petrit Çomo dhe u regjistrua më pas apartamenti në ZVRPP-në Tiranë. Ndër të tjera, thekson se apartamentin z. Petrit Çomo e ka marrë që në vitin 2003, por në atë kohë nuk ka qenë i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë;*
- lidhur me kontratën e sipërmarrjes, datë 23.11.1999, e cila shfuqizon aktmarrëveshjen e datës 27.9.1999, në nenin 2, ku përcaktohet çmimi i apartamentit në vlerën 53,000 USD (i paguar në dy këste), subjekti në lidhje me motivin e lidhjes së kësaj kontrate ka shpjeguar se, pasi shoqëria ndërtuese filloi procedurat për marrjen e lejes së ndërtimit dhe pas marrjes së saj, u kërkoi që të lironin banesën sipas marrëveshjes. Subjekti sqaron se nga konsultat ligjore me një mik, ish-profesorin e tij, i është sugjeruar se largimi nga banesa sipas marrëveshjes së përmendur më lart ishte me rrezik pavarësisht besimit të shoqërisë ndërtuese. Situata të tilla kishte ndodhur shpesh në Tiranë sepse, pasi lirohej trualli mund të dilte një pretendent i ri, mund të fillonte ndonjë proces gjyqësor dhe në përfundim mund të fitonte pretendenti i ri. Në këto kushte kur pronari i ri nuk kishte ndonjë detyrim me shoqërinë ndërtuese, marrëveshja ndërmjet palëve mund të mos vazhdonte, pallati mund të mos ndërtohej dhe ata përsëri do të mbeteshin pa asgjë. Subjekti ka shpjeguar se duke pasur parasysh këtë sugjerim i propozon përfaqësuesve të shoqërisë që dorëzimi i banesës prej tyre (subjektit dhe banorëve të tjerë të godinës ***-katëshe) të konsiderohej sikur kishin prenotuar një apartament në pallatin që do ndërtohej, pra, dorëzimi i banesës të konsiderohej si pagesë parash për prenotim banese. Pra, qëllimi i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me nr. *** kol., datë 23.11.1999, ka qenë për të qenë më i sigurt në rast se shoqëria “***” sh.p.k. nuk do të përmbushte detyrimin, për të përlllogaritur paraprakisht se kush ishte vlera e dëmit që vinte në rast mospërmbushje të detyrimit.

Në përfundim subjekti shpjegon se deklarimi i burimit të krijimit të apartamentit 2+1, me sip. 122 m², që rrjedh nga një marrëdhënie juridiko-civile pa kundërshpërbim, është në unitet me të gjitha provat e depozituara në Komision¹¹.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Lidhur me mospërputhjet e konstatuara për apartamentin me sip. 122.9 m² (në lidhje me burimin e krijimit), Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti gjatë hetimit administrativ, si dhe gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse.

Subjekti ka shpjeguar saktë se burimi i krijimit të kësaj pasurie, ashtu siç është deklaruar në deklaratën *Vetting*, është dhurimi nëpërmjet kontratës së dhurimit, datë 9.3.2012¹², që është një marrëdhënie kalimi pronësie, për rastin konkret, pa kundërshpërbim. Ky fakt, përtej një pasaktësie, përforcohet edhe me deklarin në deklaratat respektive të pasurisë ku kjo pasuri është deklaruar si trashëgimi nga babai (që nënkupton pa kundërshpërbim) gjithashtu edhe vlera prej 50,000 usd ose 7,000,000 lekë është deklaruar si vlerë ndërtimi pra si vlerë pasurie dhe jo si çmim shitje i paguar nga subjekti apo personat e lidhur me të.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka provuar plotësisht faktin se ai dhe personi i lidhur me të, nëna e tij, znj. L.B., kanë jetuar me qira në godinën ***-katëshe të ndodhur në Rr. “****”, nga ku pas lidhjes së marrëveshjes me shoqërinë “****” sh.p.k., kanë liru godinën e cila më pas është shembur dhe pas ndërtimit të pallatit në këtë truall, ka përfituar apartamentin prej 122.9 m² pa kundërshpërbim, fakt ky që përforcohet edhe me vendimin nr. ***, datë 22.10.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe me aktmarrëveshjen, datë 20.7.1999, të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasit P.R., i cili ishte qiramarrës në godinën ekzistuese sikurse dhe subjekti i rivlerësimit, ç’ka jo vetëm ka ligjëruar edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti për këtë çështje objekt vlerësimi, por objektivisht hedhin dritë për përdorimin e praktikave të njëjta të ndjekura me të gjithë qiramarrësit që liru banesat në pronësi të ish pronarëve për ndërtim.

Subjekti ka shpjeguar dhe situatën e aktmarrëveshjes së datës 20.7.1999 lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., sipas së cilës subjektit Petrit Çomo i kalonte apartamenti pa kundërshpërbim, dhe për këtë ka depozituar si provë, përveç kësaj aktmarrëveshje edhe një deklaratë noteriale ku shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga z. I.T., shpjegon situatën e përfitimit të apartamentit pa kundërshpërbim nga subjekti Petrit Çomo.

Subjekti ka shpjeguar dhe kontratën e sipërmarrjes, datë 23.11.1999, e cila ka të përcaktuar si çmim të apartamentit vlerën 53,000 USD, kontratë kjo e lidhur si garanci kundërshpërbimi nëse

¹¹ (i) Aktmarrëveshje, datës 20.7.1999, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k dhe subjektit; (ii) vendim nr. ***, datë 22.10.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iii) kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012; (iv) DPV e vitit 2013; (v) deklaratën e lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., në datën 7.1.2020 dhe shkresë nr. *** prot., datë 8.1.2020, të kësaj shoqërie drejtuar Komisionit; (vi) Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarin të pasurive” të mbajtur në datën 3.2.201, nga ILDKPK-ja; (vii) dokumentet që provojnë se familja e subjektit ka qenë qiramarrëse në vilën ***, Rr. “****”, Tiranë, si autorizimi për marrjen e banesës, akti i marrjes në dorëzim të saj, librezja e ujit dhe ajo e qirasë; si dhe (viii) pohimet dhe shpjegimet gjatë hetimit administrative, që është një nga provat që parashikohet nga Kodi i Procedurave Civile dhe një mjet provues në kuptim të gërmës “b”, të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që gjejnë mbështetje dhe harmonizohen me provat e tjera.

¹² Kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012.

shoqëria “***” sh.p.k. nuk do t’i përmbahej marrëveshjes së lidhur me subjektin. Argumentet e dhëna nga subjekti, në lidhje me arsyen e lidhjes së kësaj kontrate në këtë lloj formati, ishin bindëse.

Konkluzion

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për pasurinë “apartament” me sipërfaqe 122.9 m² me adresë: rr. “***”, Tiranë, ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse dhe ka depozituar prova të plota në lidhje me burimin e krijimit, si dhe për mënyrën e përfitimit të saj pa kundërshtim.

2. Automjet tip “Benz 180 B Class” me vlerë 14,500 euro blerja + 420,000 dogana + 1,000 euro transporti dhe kontrata.

Burimi i krijimit: (a) depozitë në shumën 10,000 euro në “Raiffeisen Bank”; (b) shitje e automjetit “Benz A Class” në shumën 4,000 euro; dhe (c) pjesë nga qiraja e banesës në shumën 4,500 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi administrativ i fakteve dhe rrethanave

Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar: *“Blerje automjeti ‘Benz B Class’ në shumën 14,500 euro, dogana 420,000 lekë dhe transporti dhe kontrata 1,000 euro”*.

DPSHTRr-ja¹³ ka përcjellë dosjen e mjetit i cili është përfituar nga kontrata e shitjes, datë 30.8.2013, përkundrejt çmimit 14,500 euro. Dokumenti doganor konfirmon se z. Petrit Çomo ka paguar taksën doganore në shumën 410,280 lekë në datën 12.9.2013.

Analizë burimit të krijimit të shumës 14,500 euro + 420,000 lekë

a) Në lidhje me burimin e parë – depozitë në shumën 10,000 euro në “Raiffeisen Bank”

Nga dokumentacioni bankar¹⁴ konfirmohet depozita në shumën 10,000 euro në “Raiffeisen Bank”, depozitë e krijuar në vitin 2008 në shumën 5,000 euro dhe e deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2008. Subjekti ka deklaruar në vitin 2009 shtesën e kësaj depozite në shumën 5,000 euro me burim krijimi të ardhurat nga qiraja. Konfirmohet nga veprimet bankare se shuma prej 10,000 euro e depozitës është tërhequr në datën 6.1.2014 në shumën 3,500 euro dhe në datën 7.1.2014 në shumën 6,650 euro.

Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi për sa i përket burimit të krijimit të të ardhurave me të cilën është blerë automjeti në shumën 14,500 euro + 420,000 lekë doganë deklaruar si burim *“depozitë në ‘Raiffeisen Bank’ në shumën 10,000 euro”*. Automjeti është blerë në datën 30.8.2013 ndërsa pagimi i doganës është bërë në datën 12.9.2013. Nga lëvizjet bankare rezulton se depozita prej 10,000 euro është tërhequr në datën 6.1.2014 dhe 6,650 euro në datën 7.1.2014, pra, pas blerjes së automjetit dhe pagimit të doganës.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë mospërputhjen e evidentuar më lart.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“... në verën 2013 vendosa të blija një automjet.....një shoku im A.T., më tha se kishte vëllain e tij që jetonte në Gjermani prej shumë vitesh dhe se djali i tij M.T., merrej me shitje makinash.....nipi i A.T., kishte gjetur një automjet të mirë, por personi do ta shiste shpejt....Unë i thashë A., se paratë nuk i kisha në atë moment pasi mund ti tërhiqja nga banka në Janar se në atë kohë maturohej depozita dhe nuk doja të humbja përqindjen. A., bisedoi*

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga DPSHTRr-ja.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

me nipin i cili pranoi që paratë t'ia dërgonim në Janar të 2014.Kur automjeti erdhi në Durrës unë kam paguar transportin, doganën dhe paratë për procedurën e regjistrimit.....Më pas shita automjetin e vjetër, tërhoqa dhe paratë nga banka dhe i dhashë A.T., dhe ky i fundit më tha se ia kishte dhënë nipit të tij M.T.,... ”.

Subjekti ka depozituar edhe deklaratën e datës 31.12.2019 (me vërtetim nënshkrimi te noteri), ku shtetasi A.T., deklaron faktin e blerjes së automjetit nga z. Petrit Çomo duke konfirmuar të njëjtat deklarime me ato të subjektit të rivlerësimit.

b) Në lidhje me burimin e dytë – shitje e automjetit tip “Benz A Class” në shumën 4,000 euro

Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë ‘Benz 170’, viti 2000 me targa *** në vlerën 7,800 euro”.*

Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar: *“Shitje automjeti ‘Benz 170 A Class’ në vlerën 4,000 euro”.*

DPSHTRr-ja¹⁵ ka përcjellë dosjen e automjetit ku rezulton se subjekti Petrit Çomo e ka blerë këtë mjet në Gjermani me çmimin 6,000 euro në datën 21.1.2005. Dokumenti doganor konfirmon se në datën 25.1.2005 është paguar edhe taksa doganore në vlerën 384,211 lekë (llogaritur me kursin ditor 126.97 lekë/euro = 3025 euro). Totali i çmimi të makinës është 6,000 euro+3,025 euro = 9,025 euro. Subjekti, me kontratën e datës 20.12.2013¹⁶, e ka shitur këtë mjet për çmimin 4,000 euro.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje deklarimi për sa i përket çmimit të blerjes së deklaruar nga subjekti. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar si vlerë blerje 7,800 euro, ndërsa nga dokumentacioni i DPSHTRr-së llogaritet vlera 9,025 euro.

Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“...kur bleva automjetin mësova se për mallrat e blera në territorin e BE, por që dilnin jashtë këtij territori, pra, kur blerësit nuk ishin banorë territori, pas verifikimit se vërtet transaksioni ishte kryer sipas rregullave, rimbursohet TVSH në vlerën 20%. Në këto kushte pas regjistrimit, unë i dhashë personit që më solli makinën, fotokopjen e lejes së qarkullimit si dhe fotokopjen e dokumenteve të tjera, fakt që vërtetonte se automjeti ishte regjistruar në Shqipëri dhe ai më zbriti nga çmimi i blerjes shumë e rimbursimit që do merrte në Gjermani kur të çonte dokumentet e makinës. Pra, unë kam deklaruar çmimin faktik që kam paguar që është 7,800 euro, duke llogaritur dhe rimbursimin”.*

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim krijimi për blerjen e këtij mjeti.

Referuar deklaratimeve në DIPP- në e vitit 2004, subjekti nuk deklaron kursime *cash*. Nga pasqyra e llogarive bankare të subjektit për periudhën 1.1.2005 – 25.1.2005 nuk rezulton që subjekti të ketë bërë tërheqje të shumave monetare nga banka. Për këtë periudhë subjekti ka pasur në dispozicion shumë prej 59,424 lekësh të mbetur pas pagesës së shpenzimeve të jetesë në shumë prej 9,130 lekësh nga të ardhurat e pagës së janarit prej 68,554 lekësh.

c) Në lidhje me burimin e tretë – pjesë nga qiraja e banesës në shumën 4,500 euro

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga DPSHTRr-ja.

¹⁶ Kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.2013.

Subjekti ka përfituar të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit me sip. 122,9 m² sipas kontratës së qirasë së lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. me çmimin 700 euro/muaj. Për këto të ardhura konfirmohet me dokumentacion provues pagesa e tatimit në burim nga subjekti tregtar.

Konfirmohet nga dokumentacioni bankar përfitimi i të ardhurave nga qiraja në llogarinë bankare në “Credins Bank”¹⁷. Në datën 13.9.2013 subjekti ka tërhequr nga llogaria bankare shumën prej 5,500 euro.

Komisioni në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar se:

- deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë prej tij, si dhe nga DPSHTRr-ja në lidhje me automjetin “Benz 180 B Class”;
- për burimin e parë, depozitë në shumën 10,000 euro në “Raiffeisen Bank”:
 - ka mospërputhje deklarimi referuar burimit të krijimit të blerjes së automjetit në vitin 2013 (në datën 30.8.2013 është paguar çmimi i mjetit, ndërsa në datën 12.9.2013 është paguar dogana), pasi depozita në “Raiffeisen Bank” është tërhequr në janar të vitit 2014;
- për burimin e dytë, shitje e automjetit tip “Benz A Class” në shumën 4,000 euro:
 - subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP në e vitit 2005 burimin e krijimit të kësaj pasurie;
 - nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me diferencën e çmimit të blerjes për shkak rimbursimit të TVSH-së, pasi nga dokumenti i disponuar në dosjen e këtij mjeti (dokumenti i shitjes) rezulton se çmimi 6,000 euro është çmimi pa TVSH;
 - subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka pasur burime financiare për pagesën e çmimit të blerjes së mjetit në shumën 6,000 euro, datë 21.1.2005, si dhe për pagesën e detyrimeve doganore në në shumën 3,025 euro, datë 25.1.2005, duke rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 1,046,500 lekë.

Pas kalimit të barrës së provës në lidhje me sa më lart, subjekti i rivlerësimit, me prapësimet e tij, ka shpjeguar se:

- lidhur me mospërputhjen se automjeti tip “Mercedes-Benz” është blerë në datën 30.8.2013, me burim depozitën 10,000 euro në “Raiffeisen Bank” tërhequr në dy shuma në janar të vitit 2014, ka shpjeguar se në procesverbalin e datës 3.2.2015, kur është thirrur në ILDKPKI lidhur me burimin e krijimit të këtij mjeti, ka deklaruar se një nipi i shokut të tij (M.T.) e ka blerë këtë automjet në Gjermani dhe ia ka dërguar në Shqipëri. Likuidimi i vlerës së këtij mjeti është bërë nga xhaxhai i tij, z. A.T. Fillimisht është paguar një shumë e vogël dhe më pas në janar të vitit 2014 është tërhequr shuma 10,000 euro. Në respektim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti sqaron se shpjegimet në ILDKPKI konsiderohen si korrigjim dhe saktësim i deklaratave të pasurisë dhe në këto kushte Komisioni duhet ta konsiderojë të saktësuar për efekt të ligjit, deklaratën e vitit 2013 për kohën e pakësimit të depozitës 10,000 euro për efekt të blerjes së automjetit që në janar të vitit 2014.

Subjekti ka depozituar dhe deklaratën noteriale të datës 31.12.2019¹⁸ me deklarues shtetasin A.T., i cili ka konfirmuar të njëjtin deklarim me atë të subjektit në lidhje me përfitimin e automjetit “Mercedes-Benz”. Gjithashtu, z. A.T., ka vijuar, më tej, duke sqaruar se: “...i thash

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019, nga “Credins Bank”.

¹⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 31.12.2019.

Petritit për këtë, por ai më tha se lekët nga banka do t'i tërhiqte në janar të vitit 2014 dhe nuk mund të paguante në çast, Gjithashtu, do të shiste edhe automjetin e tij të vjetër që e përdorte deri në atë kohë, Bisedova me nipin, i cili më tha se pranonte që paratë të paguheshin disa muaj më vonë, pra, në janar të vitit 2014. Nipi e dërgoi makinën, në Durrës e kam pritur dhe e kam marrë unë këtë automjet dhe ia kam dërguar Petritit. Petriti pagoi transportin, doganën dhe e regjistroi automjetin në emrin e tij sipas rregullave. Në janar të vitit 2014, Petriti më dha paratë për blerjen e automjetit dhe unë ja kam dhënë nipit tim M.T.,”.

Subjekti shpjegon se në DIPP- në e vitit 2014 ka deklaruar mbylljen e depozitës në “Raiffeisen Bank”, mbyllja e së cilës është deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2013, për shkak se shuma është përdorur për blerjen e mjetit, blerë në vitin 2013, paguar një pjesë në vitin 2013 dhe një pjesë në janar të vitit 2014.

- në lidhje me burimin e krijimit të automjetit “Mercedes A Class”, në DIPP-në e vitit 2005 dhe diferencës në çmimin e blerjes për shkak të rimbursimit, pasi dokumenti i shitjes pasqyron çmimin 6,000 euro pa TVSH, si dhe për mungesën e burimeve financiare për çmimin e blerjes 6,000 euro dhe pagimin e detyrimeve doganore në shumën 3,025 euro, subjekti ka shpjeguar, se ashtu siç ka deklaruar më parë në pyetësonin nr. 2, se çmimi faktik i blerjes ka qenë në vlerën 7,800 euro pasi është zbritur shuma e rimbursueshme e TVSH-së. Për të përballuar këtë blerje, subjekti deklaroi se ka tërhequr nga llogaria e tij në “Credins Bank” shumën prej 920,000 lekësh e cila është përdorur për blerjen e automjetit. Subjekti ka shpjeguar se e ka shitur automjetin “Mercedes-Benz Class” në vitin 2013 dhe, për rrjedhojë, nuk e ka deklaruar atë në deklaratën *Vetting*.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Në lidhje me mospërputhjet e konstatuara nga Komisioni për automjetin “Mercedes Benz A. Class”, blerë me çmimin 14,500 euro, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme, si dhe ka depozituar prova në mbështetje të shpjegimeve të dhëna.

Në lidhje me burimin e parë që ka shërbyer për blerjen e automjetit “Mercedes Benz A. Class”, që është depozita 10,000 euro tërhequr në “Raiffeisen Bank”, subjekti ka shpjeguar qartë mospërputhjen në deklarin të shumës 10,000 euro, pasi mjeti është blerë në gusht të vitit 2013, ndërsa depozita 10,000 euro është tërhequr në janar të vitit 2014. Kjo shumë i është paguar personit që ka sjellë automjetin në Shqipëri (nga daja e tij i cili ishte mik me subjektin), ndërsa në janar të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr shumën prej 10,000 euro në llogarinë e tij dhe ia ka likuiduar mikut të tij.

Për të provuar këtë deklarin, subjekti ka depozituar edhe deklaratën noteriale të datës 31.12.2019 të shtetasit A.T., (daja i personit që i solli subjektit automjetin “Mercedes A Class”), i cili konfirmon faktet e deklaruara nga subjekti në lidhje me përfitimin e mjetit.

Komisioni ka konfirmuar se nga lëvizjet bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” në janar të vitit 2014 janë bërë dy tërheqje përkatësisht: në datën 6.1.2014 në shumën 3,500 euro; dhe në datën 7.1.2014 në shumën 6,650 euro.

Lidhur me burimin e dytë që ka shërbyer për blerjen e automjetit “Mercedes A Class”, që është shuma 4,000 euro nga shitja e mjetit të mëparshëm, subjekti ka dhënë deklarime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e burimit të këtij mjeti në deklaratën periodike të vitit 2005.

Subjekti ka deklaruar se çmimi faktik i blerjes së automjetit ka qenë 7,800 euro, pasi është zbritur TVSH-ja, por nuk provoi pretendimin në lidhje me zbritjen e TVSH-së dhe nuk sqaroi diferencën në çmim.

Për mungesën e burimeve financiare në shumën 1,046,500 lekë, për blerjen e automjetit në datën 21.1.2005 në shumën 6,000 euro dhe pagesën e taksës doganore, datë 25.1.2005, në shumën 3,025 euro, subjekti ka deklaruar se për të përballuar këtë blerje ka tërhequr nga llogaria e tij në “Credins Bank” shumën 920,000 lekë. Pavarësisht se kjo shumë është tërhequr nga llogaria pas blerjes së mjetit, referuar faktit që veprimet për këtë pasuri janë kryer brenda vitit, balancës pozitive të konsiderueshme në vitet 2004 dhe 2005 dhe mundësisë së personit të lidhur, nënës së tij për të krijuar kursime, krijojnë bindjen se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë automjet tip “Benz 180 B Class”.

3. Depozitë në “Alpha Bank” në shumën 1,181,108 lekë

Burim krijimi: dëmshpërblim nga babai si i përndjekur politik. Pjesa takuese: 50% me nënën, znj. L.B.

Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Dëmshpërblim i babait M.Ç., si i përndjekur politik në shumën 501,000 lekë*”.

“Alpha Bank”¹⁹ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë bankare në emër të shtetasve L.B., dhe Petrit Çomo në datën 30.12.2016. Kjo gjendje në llogari është krijuar nga kalimi i dëmshpërblimit të përfituar si i përndjekur politik i babait, z. M.Ç.

Në datën 27.6.2013 nga veprimet bankare konfirmohet hapja e depozitës dyemërore në shumën 1,097,259 lekë, depozitë kjo e cila në datën 30.12.2016 rezulton me gjendje në vlerën 1,181,108 lekë.

Si burim krijimi për depozitën në shumën 1,097,259 lekë ka shërbyer depozita e mbyllur në datën 27.6.2013 në shumën 597,127 lekë (depozitë e krijuar nga dëmshpërblimi i kaluar në datën 28.6.2010) dhe depozita e mbyllur në datën 10.6.2013 në shumën 500,000 lekë (depozitë e krijuar nga dëmshpërblimi i kaluar në datën 10.5.2013).

Komisioni konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e krijimit.

4. Llogari rrjedhëse në shumën 243 lekë në “Alpha Bank”

Burim krijimi: kursime. Pjesa takuese: 25%.

“Alpha Bank”²⁰ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë bankare burimore me katër emra, L.B., Petrit Çomo, M.H., dhe T.S. Në këtë llogari janë përfituar shumat nga dëmshpërblimi si trashëgimtarë ligjorë të të përndjekurit politik M.Ç.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, nga “Alpha Bank”.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, nga “Alpha Bank”.

5. Llogari rrjedhëse në shumën 57 euro në “Alpha Bank”

Burim krijimi: kursime. Pjesa takuese: 100%.

“Alpha Bank”²¹ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë në euro.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

6. Llogari bankare dhe depozita me burim nga qiraja

6.1. Depozitë bankare pa afat në “Credins Bank” në shumën 7,539 euro

Burim krijimi: qiraja e banesës. Pjesa takuese: 100%.

“Credins Bank”²² ka konfirmuar gjendjen e llogarisë bankare në emër të z. Petrit Çomos në datën 13.1.2017. Kjo gjendje në llogari është krijuar nga kalimi i pagesave të qirave nga shoqëritë “***” dhe “***” duke filluar nga data 21.8.2009.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

6.2. Depozitë bankare në “Credins Bank” në shumën 17,408 euro

Burim krijimi: qiraja e banesës. Pjesa takuese 100%.

Nga dokumentacioni i nxjerrë nga “Credins Bank” konstatohet se subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 4,000 euro në datën 21.12.2010. Në të njëjtën datë subjekti ka transferuar të ardhurat e përfituara nga qiraja në llogarinë rrjedhëse, në llogarinë e depozitës në shumën 4,000 euro. Kjo depozitë është shtuar në vitin 2011 me shumën 7,970 euro dhe si burim ka shërbyer transferimi i të ardhurave të përfituara nga qiraja. Depozita është shtuar edhe me interesat e akumuluar.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

6.3 Llogari bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 7,152 euro

Burim krijimi: qiraja e banesës. Pjesa takuese: 100%

“Intesa Sanpaolo Bank”²³ ka konfirmuar gjendjen e llogarisë bankare në emër të z. Petrit Çomo në datë 25.1.2017. Kjo gjendje në llogari është krijuar nga depozitimi *cash* në datën 13.1.2015 i shumës 7,000 euro me përshkrimin “*sa tërhequr nga Credins Bank*”.

Nga veprimet në “Credins Bank” konfirmohet tërheqja e shumave 3,500 euro në datën 12.1.2015 dhe 3,500 euro në datë 13.01.2015, të cilat janë përfituar nga akumulimi i pagesave të qirasë në llogarinë bankare.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, nga “Alpha Bank”.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019, nga “Credins Bank”.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

6.4. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 16,469 euro

Burim krijimi: qiraja e banesës. Pjesa takuese: 100%.

Nga dokumentacioni bankar²⁴ konstatohet se subjekti ka depozituar *cash* në datën 21.12.2012 shumën 8,000 euro me burim të ardhurat nga qiraja dhe e ka investuar atë në depozitë 1-vjeçare. Konfirmohet se subjekti ka tërhequr nga “Credins Bank” shumën 7,000 euro, në datën 21.12.2012, e cila është krijuar nga pagesat mujore të qirasë.

Në datën e maturimit të depozitës 17.12.2013, subjekti ka shtuar edhe shumën prej 2,000 euro të cilat rezultojnë se janë tërhequr në datën 16.12.2013 nga “Credins Bank” me burim të ardhurat nga qiraja. Shuma prej 10,000 euro është investuar përsëri në depozitë. Në datën 17.12.2015 subjekti ka depozituar *cash* shumën prej 6,300 euro në “Intesa Sanpaolo Bank” me burim të ardhurat nga qiraja të tërhequra nga llogaria në “Credins Bank” në datën 17.12.2015.

Në datën 18.12.2015 subjekt ka çelur depozitë në shumën 16,460 euro. Banka konfirmon se gjendja e kësaj depozite më 31.12.2016 është 16,469.55 euro.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

6.5. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 23,683 USD

Burim krijimi: të trashëguara, interesa bankare dhe nga qiraja e banesës. Pjesa takuese: 100%.

Në deklaratën periodike të vitit 2003 subjekti ka deklaruar depozitë në Bankën Amerikane në shumën 10,000 USD me përshkrimin në lidhje me burimin “*të trashëguara*”. Konfirmohet nga kartela e klientit depozita për periudhën 2003 – 2010.

Subjekti, në DIPP-në e vitit 2006, ka deklaruar depozitë në shumën 6,000 USD, e cila konfirmohet edhe nga pasqyra e llogarisë bankare nga ku evidentohet depozitimi *cash* i në datën 28.12.2006.

Subjekti ka deklaruar në DIPP- në e vitit 2007 shtesën e kësaj depozitë në shumën 6,000 USD. Konfirmohet nga banka depozitimi *cash* i shumës 6,000 USD në datën 28.12.2007. Vlera e depozitës më 31.12.2007 rezulton në shumën 12,000 USD. Kjo depozitë është disponuar nga subjekti deri më 28.12.2010.

Depozitat prej 10,000 USD dhe 12,000 USD kanë shërbyer si burim krijimi për depozitën e çelur në datën 31.12.2010 në shumën 22,588.05 USD, e cila bashkë me interesat e akumulura deri më 31.12.2016 është në shumën 23,683 USD.

Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës në lidhje me këtë llogari, pasi:

- ka mungesë dokumentacioni provues ligjor për burimin e krijimit të depozitës prej 10,000 USD në vitin 2003 me të ardhura të trashëguara, depozitë kjo e cila ka shërbyer si burim krijimi për depozitën në shumën 23,683 USD.

Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova bindëse në lidhje me këtë barrë prove, të trajtuar në mënyrë të detajuar në pikën 14 të vendimit.

Kontratat e qirasë për apartamentin 2+1 me sip. 107 m² me adresë Rr. “****”, pallati “****”, nr. ****, k. ****, depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si vijon:

²⁴ Shkresë nr. **** prot., datë 20.9.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

- kontratë qiraje, datë 1.7.2005, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për një periudhë 2-vjeçare, 1.7.2005 – 1.7.2007, me vlerë 50,000 lekë e cila do jepet paradhënie për 2 muaj (i pari dhe i fundit) dhe përkatësisht në shumën 100,000 lekë/muaj;
- kontratë qiraje, datës 3.1.2007, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për një periudhë 1-vjeçare, 3.1.2007 – 3.1.2008, me vlerë qiraje 50,000 lekë e cila do jepet paradhënie për 2 muaj (i pari dhe i fundit) dhe përkatësisht në shumën 100,000 lekë/muaj;
- kontratë qiraje, datë 3.1.2008, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për një periudhë 6-mujore, 3.1.2008 – 3.7.2008, me vlerë 50,000 lekë/muaj;
- kontratë qiraje, datë 3.7.2008, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për apartamentin, për një periudhë 4-mujore, 31.7.2008 – 1.10.2008, me vlerë 50,000 lekë/muaj;
- kontratë qiraje, datë 1.11.2008, me qiramarrës shoqëria “****” sh.p.k., për një periudhë 3-mujore, 1.11.2008 – 31.1.2009, me vlerë 50,000 lekë/muaj;
- kontratë qiraje, datë 1.2.2009, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për apartamentin, për një periudhë 3-mujore, 1.2.2009 – 30.4.2009, me vlerë 50,000 lekë/muaj;
- kontratë qiraje, datë 1.8.2009, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për periudhën 16.8.2009 – 31.12.2012, me vlerë 700 euro/muaj;
- kontratë qiraje, datë 1.1.2011, me qiramarrës shoqëria “****” sh.p.k., për një periudhë 2-vjeçare, 1.1.2011 – 31.12.2013, me vlerë 700 euro/muaj.
- amendim kontratë qiraje, datë 5.12.2014, me qiramarrës shoqërinë “****” sh.p.k., për një afat të papërcaktuar që fillon nga data 1.1.2011. Palët kanë rënë dakord se vlera e qirasë do të jetë 620 euro/muaj nga ku 558 euro do t’i paguhen qiradhënësit në llogarinë e tij, ndërsa 62 euro paguhen nga qiramarrësi për tatimin në burim.

Subjekti, në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar: “*Qiraja e banesës në vlerën 2,300,000 lekë dhe 57,798 euro*”.

Komisioni ka administruar kontratat e qirasë për apartamentin me sip. 107 m² duke filluar nga data 1.7.2005 dhe mbuluar të gjithë periudhën e rivlerësimit të subjektit.

Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dokumentacionin bankar të pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga qiraja.

Për të ardhurat nga qiraja e banesës të përfituara në monedhën lekë për periudhën 1.7.2005 – 30.4.2009, nuk disponohet dokumentacion financiar i përfitimit të pagesës së qirasë, përveç kontratave.

Viti	Të ardhura nga qiraja sipas deklarimit të subjektit në DPV, monedha lekë	Të ardhura nga qiraja për të cilën është paguar tatim, monedha lekë	Tatim mbi qiranë i paguar, monedha lekë
2005	300,000	243,000	27,000
2006	600,000	540,000	60,000
2007	600,000	561,600	62,400
2008	600,000	518,400	57,600
2009	200,000	180,000	20,000
Total	2,300,000	2,043,000	227,000

Referuar përkufizimit ligjor për të ardhurat e ligjshme sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, konsiderohet e ardhur e ligjshme ajo e ardhur për të cilën është paguar tatim.

Sipas këtij përkufizimi tatimi mbi qiranë në shumën 227,000 lekë është paguar për të ardhurën *bruto* në shumën 2,270,000 lekë dhe si e ardhur e ligjshme për të cilën është paguar tatim do të konsiderohet shuma prej 2,043,000 lekësh (2,270,000 lekë – 227,000 lekë).

Për të ardhurat nga qiraja e banesës të përfituara në monedhën euro për periudhën 16.8.2009 – 31.12.2016, konfirmohet se pagesa e tyre është bërë nëpërmjet sistemit bankar.

Në llogarinë bankare në “Credins Bank” subjekti ka përfitur si të ardhura nga qiraja nga data 21.8.2009 – 31.12.2016, shumën prej 53,843 euro.

Viti	Të ardhura nga qiraja sipas deklarimit të subjektit në DPV, monedha euro	Të ardhura nga qiraja për të cilën është paguar tatim, monedha euro	Të ardhura nga qiraja kaluar me bankë, monedha euro
2009	3,150	3,150	3,675
2010	8,400	6,930	7,280
2011	8,400	7,560	7,560
2012	8,400	7,560	7,560
2013	8,400	7,560	7,560
2014	8,400	7,560	7,560
2015	6,324	6,324	6,324
2016	6,324	6,324	6,324
Total	57,798	52,968	53,843

Subjekti, në deklaratimet e tij periodike në lidhje me të ardhurat nga qiraja, i është referuar vlerës *bruto* të qirasë dhe jo vlerës së mbetur prej saj pas zbritjes së tatimit mbi qiranë.

Për vitin 2010 subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja shumën 8,400 euro (vlera *bruto* e kontratës së qirasë 700 euro/muaj x 12 muaj), por nga pagesat e kaluara në bankë ka rezultuar të ketë përfitur të ardhura në shumën 7,280 euro. Nga dokumentacioni bankar rezulton të jetë paguar 770 euro tatim në burim dhe të ardhurat e ligjshme për të cilën janë paguar tatimet janë në shumën 6,930 euro.

Për vitet 2011 – 2014, subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike të ardhura nga qiraja në shumën 8,400 euro, ndërkohë që ka përfitur nëpërmjet pagesave bankare shumën 7,560 euro, shumë për të cilën konfirmohet nga dokumentacioni pagesa e tatimit të qirasë.

Për vitet 2015 – 2016, subjekti ka deklaruar saktë të ardhurën e përfitur nga qiraja, për të cilën është konfirmuar edhe pagesa e tatimit në burim.

Komisioni në lidhje me të ardhurat nga qiraja ka konstatuar se:

- a) ka mospërputhje deklarimi për sa i përket të ardhurave nga qiraja për vitet 2005 – 2008, ku subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore të ardhura nga qiraja në shumën totale 2,100,000 lekë, ndërkohë nga dokumentacioni i pagesës rezulton se për këtë periudhë është paguar tatim në shumën 207,000 lekë dhe e ardhura e ligjshme është në shumën 1,893,000 lekë (2,100,000 – 207,000).
- b) ka mospërputhje deklarimi për sa i përket të ardhurave nga qiraja për vitet 2010 – 2014, ku subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore të ardhura nga qiraja në shumën 8,400

euro/vit (vlera *bruto* para zbritjes së tatimit), ndërkohë nga dokumentacioni rezulton se për vitin 2010 ka përfituar 6,930 euro dhe për vitet e tjera shumën 7,560 euro (vlera *neto* pas zbritjes së tatimit).

Pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në vitet e para të deklaramëve në ILDKPKI ka deklaruar qiranë *bruto* dhe jo *neto* dhe kjo për faktin se ka dashur të pasqyrojë me saktësi shumën që pasqyrohet në kontratën e qirasë.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Subjekti i rivlerësimit ka pranuar që mospërputhjet në deklaram janë pasaktësi të bëra prej tij, por qëllimi ka qenë për të pasqyruar në mënyrë të saktë shumën e përfituar nga qiradhënia.

Konkluzion

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Deklarimi i pasaktë i shumave të përfituara nga marrëdhënia e qirasë nuk përbën shkak për ngarkimin me përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që në analizën financiare janë pasqyruar të ardhurat *neto* nga marrëdhënia e qirasë, pas zbritjes së tatimit përkatës.

7. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në shumën 57 lekë

Burim krijimi: kursime. Pjesa takuese: 25%.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP- në e vitit 2009 çeljen e depozitës në shumën 10,000 lekë me pjesë takuese 25% dhe në DIPP- në e vitit 2010 mbylljen e kësaj depozitë në shumën 10,000 lekë me pjesë takuese 25%.

“Credins Bank” ka konfirmuar depozitim *cash* të shumës 10,000 lekë në datën 19.12.2009, si dhe tërheqjen *cash* në datën 29.6.2010. Nga dokumentacioni bankar konfirmohet gjendja e llogarisë bankare në emër të shtetasve Petrit Çomo, L.B., M.H., dhe T.S., në datën 31.12.2016.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ.

8. Depozitë bankare në “Credins Bank” në shumën 800,017 lekë, të ardhura që rrjedhin nga shitja e aksioneve të shoqërisë “**” sh.a.**

Burim krijimi: shitje aksionesh të shoqërisë “****” sh.a. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi administrativ i fakteve dhe rrethanave

Në deklaratën për herë të parë të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: “*Aksione në shoqërinë ‘***’ sh.a., *** numri i aksioneve me vlerë 3.7 milion lekë me burim të dhuruara*”, ndërsa në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Shitje aksionesh të shoqërisë ‘***’ sh.a., në vlerën 1,600,000 lekë*”.

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së pasurive të luajtshme “aksione”, datë 4.6.2004²⁵, me shitës shtetasit Petrit Çomo, T.S., dhe M.H., dhe blerës shoqërinë “****” sh.a., me përfaqësues shtetasin Sh.D., me objekt kalimi i pronësisë së *** aksione të depozituara nga pala paditëse pranë shoqërisë “****” sh.a. Bazuar në këtë kontratë, z. Petrit Çomo, ka në pronësi *** aksione dhe çmimi i blerjes së një aksioni është 392,67 lekë. Nga përlllogaritjet rezulton se të ardhurat e krijuara nga shitja e aksioneve janë: 3,722 aksione x 392,67 lekë/aksion = 1,461,517.74 lekë

²⁵ Kontratë e shitblerjes së aksioneve nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2004.

Subjekti ka depozituar dokumentin e lëshuar nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve²⁶ që konfirmon se z. Petrit Çomo zotëron te shoqëria “***” sh.a., 3722 aksione ose përqindje 1.315%, transferuar nga z. P.P.

“Credins Bank”²⁷ ka konfirmuar gjendjen e depozitës bankare në emër të z. Petrit Çomo në datën 31.12.2016, në shumën 800,0017 lekë. Kjo depozitë është krijuar fillimisht nga depozitimi *cash* i shumës 1,600,000 lekë, në datën 21.6.2004. Në vitin 2005 kjo depozitë është shtuar me interesa bankare. Gjendja e depozitës pas tërheqjes *cash* të shumës 922,220 lekë, në datën 22.6.2005, ka rezultuar në shumën 800,002 lekë. Për vitet në vazhdim deri në vitin 2016, kjo depozitë ka gjeneruar interesa të cilat janë tërhequr *cash* nga subjekti deri në vitin 2009 ose janë transferuar në llogarinë rrjedhëse nga viti 2010 dhe në vazhdim duke bërë që llogaria e depozitës bankare të mbetet në shumën 800,017 lekë.

Komisioni ka konstatuar se në lidhje me aksionet e përfituara nga shoqëria “***” sh.a.: (i) subjekti nuk ka depozituar kontratën e dhurimit të datës 27.7.2000²⁸, nga ku janë përfutur këto aksione; (ii) në DIPP- në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar shitjen e këtyre aksioneve dhe vlerën e shitjes së tyre; (iii) ka mospërputhje të vlerës së deklaruar në deklaratën *Vetting* në shumën 1,600,000 lekë me të ardhurat e llogaritura të përfituara nga kontrata e shitjes në shumën 1,461,517.74 lekë.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “...*babai im M.Ç., mori letra me vlerë si i përndjekur politik. Djali i motrës së tij P.P., ishte përgjegjës i njëjës prej fabrikave të bukës. Meqë kishte filluar privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore, P.P., i kërkoi babait tim letrat me vlerë që ti përdorte për privatizimin e ndërmarrjes...nuk jam i sigurt për shumën e letrave me vlerë që babai i dha nipit të tij.....por vlera e tyre në atë kohë ishte rreth 3,200,000 lekë.*

*Me sa mbaj mend, P.P., mori pjesë në privatizim dhe u bë aksioner ashtu si gjithë punonjësit e tjerë të ndërmarrjes dhe sipas letrave me vlerë mori më shumë aksione (sipas dokumenteve 7444 aksione, 2.67...% të numrit të përgjithshëm të aksioneve. Ndërmarrja funksionoi si një e tërë dhe nuk u nda si pretendonte P.P. Pasi vdiq babai im M.Ç.,...në kushtet kur P.P., nuk e privatizoi dot fabrikën ku punonte, na i ktheu ne trashëgimtarëve të dajës së tij M.Ç., aksionet që ia kishte dhënë ky i fundit. Ky kthim u bë me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2000. Me pëlqimin e nënës sime P.P., më dhuroi mua pjesën e saj dhe timen, pra, gjysmën e aksioneve, pra, nga 1861 aksione secila. Më pas...bashkë me motrat vendosëm të shisnim aksionet te shoqëria ‘***’ sh.a., me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2004.*

Për sa i përket diferencës për shumën e përfutur ka qenë se ne i kishim regjistruar aksionet në qendrën e regjistrimit të aksioneve sh.a, pra kishim kryer shpenzime. Këto shpenzime u rimbursuan nga shoqëria blerëse....Prandaj mendoj se ekziston një diferencë ndërmjet çmimit që thoni ju në pyetjen tuaj dhe çmimit faktik që kemi marrë unë dhe motrat e mia me këtë shitje. Kanë kaluar 15 vjet dhe unë nuk kam ndonjë dokumentacion tjetër ligjor për përfitimin e shumës 1,600,000 lekë përveç kontratës së shitjes dhe 1,600,000 lekë i kam depozituar në ‘Credins Bank’.

Është e vërtetë që në deklaratën e vitit 2004 nuk është deklaruar shitja e tyre..., por në deklaratë është shënuar si pasuri vlera 1,600,000 lekë të depozituara në ‘Credins Bank’, pra, është

²⁶ Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA).

²⁷ Shkresë nr. ***, datë 23.10.2019, nga “Credins Bank”.

²⁸ Kontrata e dhurimit të aksioneve nr. *** rep., nr. *** kol.

deklaruar shuma e lekëve të përfituara nga shitja e aksioneve. Kjo shumë është deklaruar si depozitë bankare në 'Credins Bank' në DIPP-në e vitit 2004".

Subjekti ka depozituar kontratën e dhurimit, datë 27.7.2000²⁹, me dhurues z. P.P., dhe pranues të dhurimit z. Petrit Çomo etj., me objekt dhurim aksionesh të depozituara pranë shoqërisë "****" sh.a., 2,922,411 lekë privatizimi që zënë 7,444 aksione me 2,67428224257 % të kapitalit të shoqërisë "****" sh.a., të cilat ua dhuron:

- zj. T.S., i dhuron nga pjesa që zotëron në kapitalin e kësaj shoqërie 1861 aksione që përfaqësojnë 0.6573575 % të kapitalit të shoqërisë;
- zj. M.H., i dhuron nga pjesa që zotëron në kapitalin e kësaj shoqërie 1861 aksione që përfaqësojnë 0.6573575 % të kapitalit të;
- z. S.Ç., i dhuron nga pjesa që zotëron në kapitalin e kësaj shoqërie 3722 aksione që përfaqësojnë 1.3147715 % të kapitalit të shoqërisë.

Nga kjo kontratë dhurimi, subjekti ka përfituar 3722 aksione me vlerë 1,461,206 lekë.

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", në nenin 8 përcakton si të ardhur të tatueshme të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së aksioneve. Subjekti i rivlerësimit ka shitur aksionet e përfituara nga dhurimi me çmim të njëjtë me çmimin e dhurimit duke mos krijuar shtesë vlere. Në lidhje me fitimin kapital nga dhurimi sipas ligjit të kohës³⁰ subjekti nuk ka pasur detyrim për pagesë tatimi.

Komisioni ka konstatuar mospërputhje deklarimi për sa i përket vlerës së aksioneve të dhuruara, pasi në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 subjekti deklaroi aksione të dhuruara në shumën 3,700,000 lekë, ndërkohë nga kontrata e dhurimit rezulton vlera 1,461,206 lekë.

Në lidhje me këtë mospërputhje, subjekti ka shpjeguar se: *"Është e vërtetë që në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, unë kam deklaruar se jam pronar i 3722 aksioneve të shoqërisë '****' sh.a., Tiranë, duke përcaktuar vlerën e tyre 3.7 milionë lekë, duke u llogaritur 1,000 lekë aksioni. Kjo ka qenë vlera fillestare e aksioneve sipas dijenisë time në atë kohë.... Pra, ndryshimi i deklarimit në deklaratën e vitit 2003 me vlerën e vërtetë të aksioneve në momentin e shitjes sipas kontratës së datës 4.6.2004, vjen nga vlera e ndryshme e aksioneve në kohë të ndryshme... Në deklaratë është shënuar vlera e aksioneve në momentin fillestar (gjithnjë sipas informacionit që unë kisha në atë kohë), ndërsa në kontratë është shënuar vlera e tyre reale sipas tregut, mendoj sipas Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve apo vendimeve të drejtueseve të shoqërisë..."*

Komisioni ka hetuar dhe çështjen e konfliktit të interesit së subjektit të rivlerësimit me shoqërinë "****" sh.a.³¹ dhe nga hetimi nuk ka rezultuar ndonjë situatë e tillë.

Komisioni, në lidhje me aksionet e shoqërisë "**" sh.a., ka konstatuar se:**

- subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor përfitimin e letrave me vlerë në formën e dëmshpërblimit nga babai tij;
- është i paqartë dhe i padokumentuar transferimi i letrave me vlerë nga babai i subjektit te shtetasi P.P.;

²⁹ Kontrata e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.7.2000.

³⁰ Detyrimi për tatimin nga të ardhurat nga fitimet kapitale nga dhurimi është futur në legjislacion me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010, botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. ***, datë 3.12.2010.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.2.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota në lidhje me diferencën ndërmjet shumës 1,600,000 lekë deklaruar në deklaratën *Vetting* të përfituara nga shitja e aksioneve, dhe shumës së përfituar në shumën 1,461,517.74 lekë që pasqyrohet në kontratën e shitjes;
- subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor që diferenca në vlerën 138,483 lekë (1,600,000 – 1,461,517 lekë) është rimbursuar nga shoqëria blerëse;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shitjen e aksioneve dhe vlerën e shitjes së tyre në deklaratën periodike të vitit 2004;
- subjekti ka shpjeguar mospërputhjen për sa i përket deklaratimit të vlerës së aksioneve në vitin 2003, si deklarim fillestar në shumën 3.700,000 lekë, me vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes në shumën 1,461,206 lekë.

Në lidhje me barrën e provës të kaluar me rezultatet e hetimit si më sipër, subjekti ka shpjeguar se u qëndron shpjegimeve të dhëna në pyetësorët e mëparshëm duke qartësuar se veprimet juridike kanë qenë ndërmjet personave me lidhje familjare me njëri-tjetrin (shtetasi P.P., është djali i motrës së babait të subjektit). Letrat me vlerë janë përfituar nga babai i subjektit si ish i burgosur politik. Ky fakt provohet me VKM-në nr. 1147, datë 25.11.2009, si dhe me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtoria e Pagesave të Dëmshpërblimeve.

Në lidhje me diferencën në shumën prej 138,483 lekësh, që siç deklaroi subjekti është fakt i ndodhur përpara 16 vjetësh, ka qenë për faktin se nga gjithë aksionerët të cilëve u kishte blerë aksione shoqëria “****” sh.a., vetëm subjekti me motrat i kishin aksionet e regjistruara në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve (në të gjithë botën, çmimi i aksioneve është i ndryshueshëm në çdo kohë).

Në lidhje me mosdeklarimin në DIPP- në vitin 2004 në rubrikën e të ardhurave, subjekti deklaroi se nuk ka shënuar përfitimin nga shitja e aksioneve për pakujdesi, por në të njëjtën deklaratë ka shënuar hapjen e një depozite në shumën 1,600,000 lekë në “Credins Bank”. Kjo depozitë është krijuar nga shitja e aksioneve dhe paratë janë depozituar në bankë. Subjekti ka deklaruar se ka dhënë shpjegime edhe në ILDKPKI në vitin 2015 në lidhje me depozitën në shumën prej 1,600,000 lekësh, të përfituara nga shitja e aksioneve.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se nga verifikimi i VKM-së nr. 1147, datë 25.11.2009, rezulton se z. M.Ç., i pasqyruar në listë me numër rendor 134, të jetë përfitues për vlerën 400,000 lekë dhe 2,934,136 lekë në letra me vlerë.

Në lidhje me transferimin e letrave me vlerë nga babai i subjektit të shtetasi P.P., (nipi i tij), subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme referuar lidhjes së ngushtë familjare ndërmjet dy personave.

Lidhur me diferencën e konstatuar nga shitja e aksioneve, në shumën 138,483 lekë (1,600,000-1,461,517 lekë), subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota. Gjithashtu, nga lëvizjet bankare, Komisioni ka konfirmuar depozitën në “Credins Bank”, në shumën 1,600,000 lekë, të krijuar në datën 21.6.2004.

Subjekti, gjithashtu, ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me mosdeklarimin e shitjes së aksioneve në vitin 2004, duke e qartësuar si deklarim në formën e depozitës bankare.

Në paragrafin e dytë, të nenit 30, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.199, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, përcaktohet se: “Gjyqtarëve u ndalohet të marrin pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive civile ose tregtare, personalisht ose me

anë përfaqësimi”. Nga hetimi nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit, përveçse aksioner pasiv, të ketë qenë administrator apo në struktura të tjera drejtuese në shoqërinë “***” sh.a., përgjatë kohës së zotërimit në pronësi të aksioneve në këtë shoqëri.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me shitjen e aksioneve të shoqërisë “***” sh.a.

Pasaktësia në deklaram që i korrespondon diferencës në shumën prej 138,483 lekësh, ndërmjet vlerës së deklaruar të aksioneve me vlerën e shitjes së tyre, vlerësohet se nuk përbën ndonjë problematikë që mund të ngarkojë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, përderisa në analizën financiare është marrë në konsideratë vlera e provuar si e përfituar nga shitja e tyre prej 1,461,517.74 lekësh.

9. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në shumën 14,853 lekë

Burimi i krijimit: kursime. Pjesa takuese: 100%

Nga dokumentacioni bankar ³² konfirmohet gjendja e llogarisë në shumën 14,853 lekë.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit.

10. Llogari rrjedhëse (rroga) në “Credins Bank” në shumën 51,072 lekë, në momentin e dorëzimit të deklaratës

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe shpërblime të tjera, kompensim celulari, honorarë nga mbledhjet e KLD-së.

“Credins Bank”³³ konfirmon gjendjen e llogarisë së deklaruar nga subjekti.

Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit.

11. Gjendje cash në shumën 300,000 lekë në banesë

Burimi i krijimit: kursime. Pjesa takuese: 100%.

Komisioni, në lidhje me gjendjen cash në shumën 300,000 lekë, ka konstatuar se:

- Referuar analizës financiare të vitit 2016, subjekti dhe nëna e tij nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme në shumën 304,132 lekë për të krijuar kursimet dhe për të mbuluar shpenzimet, pasi ky vit ka rezultuar me balancë financiare negative.

Pas kalimit të barrës së provës me rezultatet e hetimit, subjekti ka shpjeguar se arsyeja e kësaj difference negative, në vlerën prej 304,132 lekësh, lidhet me faktin se edhe pse nëna e tij që prej vitit 2005 – 2016 nuk ka qenë subjekt deklarimi, i është konsideruar se shuma e deklaruar *cash* është krijuar në vitin 2016, ndërkohë që nëna e subjektit në faqen 19 të deklaratën *Vetting*, lidhur me burimin e krijimit të shumës 1,400,000 lekë, ka deklaruar “*të ardhura nga shitja e pronave, kursime*”. Subjekti shpjegon se kursimet e nënës nuk lidhen vetëm me një vit, por me gjithë jetën e saj.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se subjekti ka argumentuar diferencën financiare negative të vitit 2016, si rezultat i llogaritjes së kursimeve *cash* të deklaruara nga nëna e tij në deklaratën *Vetting* në shumën

³² Shkresë nr. ***, datë 23.10.2019, nga “Credins Bank”.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019, nga “Credins Bank”.

1,400,000 lekë, si kursime të krijuara vetëm në vitin 2016, ndërkohë që këto kursime janë të krijuara ndër vite.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me balancën financiare negative për vitin 2016, si dhe kursimet *cash* të deklaruara nga nëna e tij në deklaratën *Vetting*, duke i konsideruar kursimet *cash* të nënës së subjektit të shtrira në kohë, në të gjithë periudhën e hetimit të kryer.

TË ARDHURA TË TJERA

12. Shitje apartamenti në rr. “**”, blloku ***, pallati ***, Tiranë, me kontratën e shitjes, datë 8.10.2001,³⁴ në vlerën 1,800,000 lekë (½ e vlerës së apartamentit i cili është shitur 3,600,000 lekë)**

ASHK-ja Drejtoria Vendore Tiranë -Veri³⁵ ka konfirmuar se në emër të shtetasve L.B., dhe Petrit Çomo ka qenë regjistruar pasuria, apartament me sip. 74,99 m²,³⁶ me adresë Rr. “****”, Tiranë, e cila është transkriptuar.

Apartamenti është përfituar nga kontrata e shitjes, datë 20.8.2001,³⁷ lidhur ndërmjet EKB-së Dega Tiranë, në cilësinë e shitësit dhe znj. L.B., në cilësinë e blerësit. Në kontratë përcaktohet vlera e apartamentit në shumën 1,648,001 lekë, por meqenëse blerësi ka statusin e invalidit të luftës, e përfiton apartamentin falas dhe paguan vetëm 4% të vlerës për veprime operacionale në shumën 65,012 lekë.

Referuar parashikimeve të kontratës së privatizimit, si dhe referencave ligjore të përcaktuar në kontratë, rezulton se ky apartament është përfituar nga znj. L.B., me statusin e invalidit të luftës ku emri i saj është përmendur në VKM-në përkatëse dhe përfiton apartament 2+1 në zonën e “****”, Tiranë.

Kontrata e datës 17.8.2001, në nenin II, në pikën c, pasqyron se: “*Meqenëse blerësi ka statusin e invalidit të luftës në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore dhe pikës 4, të VKM-së nr. 434, datë 4.8.2000, përfiton banesën falas = 1,648,001 lekë’*”.

Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “ Për privatizimin e banesave shtetërore”, në nenin 7 të tij parashikon: “*Banesat, me të cilat qiramarrësi ose pjesëtarë të tjerë të familjes së tij që banojnë me të, kanë statusin e ish-të burgosurit, të internuarit dhe të dëbuarit politik, si dhe të invalidit të luftës, kalojnë në pronësi të tyre falas. Subjektet e përmendura në paragrafin e mësipërm, kur janë të pastrehë dhe do të sistemohen në banesa shtetërore, brenda normativave të strehimit, do t'i marrin ato falas*”.

Ndërsa VKM-ja nr. 434, datë 4.8.2000, “Për strehimin e familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që banojnë në shtëpi, ish-pronë private, dhe për familje të pastreha të invalidëve“, në pikën 1 parashikon: “*Sistemimin me banesa të familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të qytetit të Tiranës, në rrugën ‘****’, nga fondet e banesave të*

³⁴ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2001.

³⁵ ASHK-ja Drejtoria Vendore Tirana-Veri shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019.

³⁶ Pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

³⁷ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.8.2001.

Entit Kombëtar të Banesave. Shpërndarja e tyre do të bëhet në bazë të listës (bashkëlidhur tabela), të dërguara nga Bashkia e Tiranës”.

Në pikën 4 të tij parashikohet: “*Enti Kombëtar i Banesave, sipas listave, të shoqëruara me strukturat përkatëse, vë në dispozicion të secilit qytetar të pastrehë, invalid lufte, shumën limit të përfitimit falas. ... për apartamentet 2 + 1 në shumën 2 137 milionë leke.*”

VKM-ja ka të bashkëngjitur listën emërore të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe struktura e apartamenteve që përfitojnë në Tiranë ku me numër rendor *** në listë është L.B., 2+1.

Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe nënës së tij për pagesën e shumës 65,012 lekë, në datën 17.8.2001, nga ku ka rezultuar se kanë pasur burime të mjaftueshme të ligjshme.

Apartamenti i mësipërm me kontratën e shitjes së datës 8.10.2001³⁸, iu është shitur blerësve Qeramedin dhe V.K., me çmimin 3,600,000 lekë. Për këtë apartament shitësit kanë paguar tatimin përkatës mbi të ardhurat sipas mandatit të Bankës së Kursimeve, datë 10.10.2001.

Komisioni vëren se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja duke mos u konstatuar ndonjë problematikë.

Konkluzion

Apartamenti në rr. “***” është përfituar në përputhje me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe VKM-në nr. 434, datë 4.8.2000, “Për strehimin e familjeve të invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që banojnë në shtëpi, ish-pronë private, dhe për familje të pastreha të invalidëve”, ku nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. L.B., e ka përfituar atë me statusin e invalidit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

13. Dëmspërblim në shumën 501,000 lekë, nga babai M.Ç., si i përndjekur politik (kjo e ardhur është trajtuar në pikën 3 të vendimit)

14. Trashëgimi nga babai në shumën 10,000 USD deklaruar në deklarinin fillestar

Hetimi administrativ i fakteve dhe rrethanave

Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003: “*Depozitë në Bankën Amerikane në shumën 10,000 USD me burim krijimi ‘të trashëguara’*”.

Komisioni, me kalimin e barrës së provës me rezultatet e hetimit, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 10,000 USD, deklaruar dhe përfituar si trashëgimi nga babai.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se babai i tij, i cili ka ndërruar jetë në janar të vitit 1998 i ka lënë shumën 10,000 USD dhe nuk ka pasur dokumente ligjore për të provuar të ardhurat dhe se babai i ka administruar personalisht të ardhurat e tij.

Subjekti deklaroi si provë një vendim gjyqësor nr. 1229, datë 26.2.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë³⁹ me anë të të cilit provohet se babai i tij ka marrë pensione të papaguara për

³⁸ Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2011.

³⁹ Lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 12.4.1996, të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. ***, datë 26.6.1996, të Gjykatës së Kasacionit, e cila ka pranuar padinë e z. M.Ç.

periudhën 1972 – 1987, pensionet e paguara më pak që i takonin nga viti 1987 e në vazhdim, si dhe vendimin nr. ***, datë 3.10.1996, të DRSSH-së për zbatimin e vendimit gjyqësor.

Gjithashtu, bazuar edhe te shkresa nr. *** prot., datë 17.7.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtoria e Pagesave të Dëmshpërblimeve, rezulton se babai i subjektit është rimbursuar si i përndjekur politik me shumën 200,000 lekë dhe 2,934,136 lekë letra me vlerë, pasqyruar kjo në VKM-në nr. 1147, datë 25.11.2009.

Subjekti ka depozituar si prova, ndër të tjera, edhe fotokopje të letrave me vlerë. Ai deklaron se babai mund të ketë pasur edhe të ardhura të tjera, por duke qenë se ka 22 vjet që ka ndërruar jetë, nuk mund të gjejë dokumente të tjera ligjore që të provojë të ardhurat e plota të tij duke pretenduar se ndodhet në kushtet e parashikuara të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se shuma prej 10,000 USD, e deklaruar si trashëgimi nga babai, është krijuar nga pensione të papaguara të periudhës 1972 – 1987, si dhe nga pensionet e paguara më pak që i takonin nga viti 1987 e në vazhdim. Këto pensione të papaguara subjekti i rivlerësimi i ka provuar duke vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 26.2.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili ka rrëzuar kërkesën e z. M.Ç., dhe i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 14.4.1996, ndërsa Gjykata e Kasacionit, me vendimin nr. ***, datë 26.6.1996, ka vendosur prishjen e dy vendimeve të sipërcituara dhe pranimin e padisë.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar si provë edhe shkresën nr. ***, datë 15.7.2020, të ISSh-së (Drejtoria Rajonale Tiranë), ku konfirmon se është zbatuar vendimi nr. ***, datë 26.6.1996, i Gjykatës së Kasacionit Tiranë për z. M.Ç., i cili ka përfituar shumën 881,801 lekë me datë 3.10.1996.

Si të ardhura të tjera, subjekti ka deklaruar se kanë qenë edhe shumat që babai i tij ka përfituar dëmshpërblim si i përndjekur politik dhe ky fakt vërtetohet nga VKM-ja nr. 1147, datë 25.11.2009, ku në listën bashkëngjitur këtij vendimi me nr. rendor *** rezulton se z. M.Ç., është përfitues i vlerës 400,000 lekë dhe 2,934,136 vlerë letra me vlerë.

Si provë tjetër për krijimin e shumës 10,000 USD subjekti ka depozituar shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e pagesave të dëmshpërblimeve) ku z. M.Ç., i është disbursuar vlera totale prej 3,000,000 lekësh.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimi ka dhënë shpjegime të plota, bindëse, si dhe ka depozituar prova të plota duke provuar burimin e ligjshëm të shumës 10,000 USD të lënë trashëgim nga babai i tij M.Ç.

Deklarimet e pasurive nga nëna e subjektit, znj. L.B.,

15. Apartament banimi me sip. 91.20 m²⁴⁰ me vendndodhje Blv. “**” (***), ap. 7, me vlerë 12,011,040 lekë sipas çmimeve të përcaktuara me VKM, zona *****

Burimi i krijimit: përfituar si bashkëpronare trualli. Pjesa takuese: 100 %.

⁴⁰ Appartement në z. k. ***, vol. ***, f. ***, nr. pasurie ***, me vlerë 12,011,040 lekë, me certifikatë pronësie nr. ***.

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë Jug⁴¹ ka konfirmuar se në emër të z. Petrit Çomo është regjistruar pasuria apartament me sip. 91.20 m², z. k. ***, me vendndodhje Blv. “***” Tiranë, përfituar me dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 18.7.2018.

Subjekti ka depozituar si dokumente provuese:

i) dëshminë e trashëgimisë datë 18.7.2018;

ii) aktmarrëveshjen datë 15.5.1999⁴² ndërmjet pronarëve të truallit, familja C., dhe familja B., përfaqësuar nga z. F.B., me shoqërinë “***” sh.p.k., duke vënë në dispozicion truallin e tyre respektivisht me sip. 80 m² familja C., dhe 171 m² truall + 16 m² ndërtim familja B., me qëllim përfitimin në këmbim të 25 % të sipërfaqes ndërtimore të pallatit që do të ndërtojë kjo shoqëri në blv. “***” Tiranë;

iii) kontratën e sipërmarrjes datë 16.6.2000⁴³, ku sipërmarrësi shoqëria “***” sh.p.k. dhe porositesit familja C., dhe familja B., i vënë në dispozicion kësaj shoqërie sipërfaqet respektive ku pronarët e truallit do të përfitojnë 25 % të sipërfaqes ndërtimore;

iv) kontratën e shkëmbimit datë 24.5.2001⁴⁴ (dërguar nga ASHK-ja) me palët si më sipër;

v) kontratën e pjesëtimit vullnetar datë 26.9.2001⁴⁵, ku shtetasit L., F., F., A., dhe P.B., ndajnë apartamentet që kanë përfituar në bashkëpronësi dhe konkretisht znj. L.B., ka përfituar ap. ***, k. ***, 2+1 me sip. 91.2 m². Gjithashtu, palët L., F., F., A., dhe P.B., rezultojnë të jenë bashkëpronarë në pjesë të barabarta: në katin përdhes një dhomë+ballkon me sip. 13.2 m², në katin e parë një dhomë+ballkon me sip.18.2 m²; në katin e dytë një dhomë+ballkon me sip.17.8 m².

Komisioni vëren se deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja dhe subjekti të administruara gjatë hetimit administrativ.

16. Truall me sip. 861 m², nr. pasurie *, regjistri hipotekor nr. ***, datë 9.7.2012, Ballsh, vlera nuk mund të përcaktohet**

Burimi i krijimit: trashëgimi, kthim pronash. Pjesa takuese: 20 %.

ASHK-ja, Zyra Vendore Mallakastër⁴⁶ ka konfirmuar se z. Petrit Çomo është bashkëpronar me 1/20 pjesë (5 %) në pasurinë truall me sipërfaqet 75 m², 235 m² dhe 861 m².

Komisioni, referuar përgjigjes së Zyrës Vendore Mallakastër, ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit është bashkëpronar dhe me 1/20 pjesë të pasurive të paluajtshme truall me sipërfaqet 75 m² dhe 235 m², të cilat nuk rezultojnë të deklaruara as në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *Vetting* dhe për këtë qëllim i kërkoi shpjegime subjektit.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “... këto pasuri pas vdekjes së nënës në datën 23.4.2018 kanë kaluar në pronësinë time. Kur kam plotësuar deklaratën *Vetting* në janar të vitit 2017, nëna ime ka qenë mbi 90 vjeç dhe e sëmurë. Në këto kushte jam përpjekur të gjej dokumente për pasurinë e saj, si dhe kam pyetur atë për këto pasuri. Për sa i përket pasurive truall në Mallakastër, janë shënuar në deklaratën *Vetting* sipas vërtetimit lëshuar nga ZVRPP-ja Mallakastër, datë 12.10.2016. Ky vërtetim është lëshuar përpara se në këto prona të kryhej

⁴¹ ASHK-ja, Tirana Jug me nr. *** prot., datë 15.10.2019.

⁴² Aktmarrëveshja nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.5.1999.

⁴³ Kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.6.2000.

⁴⁴ Kontrata e shkëmbimit me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.4.2001.

⁴⁵ Kontrata e pjesëtimit vullnetar nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2001.

⁴⁶ ASHK-ja, Zyra Vendore Mallakastër me nr. *** prot., datë 15.10.2019.

regjistrimi fillestar pas të cilit pronarët do pajiseshin me vërtetimin dhe kartelën përkatëse. Te ky vërtetim është shënuar vetëm një pasuri. Gjithashtu te ky vërtetim nuk ishin përcaktuar në mënyrë të saktë pjesët e palëve pasi ishin regjistruar gabim pjesët e trashëgimtarëve të vëllait të nënës sime, të ndjerit F.B. Pas vdekjes së nënës sime dhe marrjes së dëshmisë së trashëgimisë, unë iu drejtova ZVRPP-së Mallakastër duke kërkuar që në pronat tona të kryhej regjistrimi fillestar dhe ne të pajiseshim me vërtetimet dhe kartelat përkatëse të pasurisë sipas ligjit. Gjithashtu dërgova dhe dëshmitë e trashëgimisë së nënës, si dhe katër vëllezërve të vdekur përpara saj F., B., F., dhe P.B. Pas regjistrimit fillestar dhe përcaktimit të saktë të pjesëve të secilit bashkëpronar, ZVRPP-ja Mallakastër na pajisi me vërtetimet dhe kartelat përkatëse të pasurisë, bashkëlidhur listën e bashkëpronarëve dhe pjesët takuese të secilit, të shënuara saktësisht. Pas marrjes së këtyre dokumenteve, në deklaratën e pasurisë së vitit 2018 unë kam shënuar saktësisht pronat e përfituara nga trashëgimia e nënës sipas vërtetimeve përkatëse...”.

Subjekti, në përgjigje të këtij pyetësi, ka depozituar si dokumentacion provues:

- a) vërtetimin e lëshuar nga ASHK-ja Zyra Vendore Mallakastër, të vitit 2019, ku konfirmon se z. Petrit Çomo rezulton bashkëpronar me 1/20 pjesë për pasurinë “truall” me sip. 235 m², me 4/20 pjesë të pasurisë “truall” me sip. 861 m² dhe 4/20, pjesë të pasurisë “truall” me sip. 75 m²;
- b) vërtetimin datë 12.10.2016, të ZVRPP-së Mallakastër, që sipas deklarimit të subjektit, plotësimi i deklaratës *Vetting* për këto pasuri është bërë sipas këtij vërtetimi, i cili pasqyron se znj. L.B., është bashkëpronare e pasurisë truall me sipërfaqe totale 3,168 m², regjistruar në vitin 2005, ndodhur në Mallakastër, Ballsh dhe pasuria 9/81 është ndarë në pasuritë: 9/139 me sip. 348 m², e regjistruar në bashkëpronësi, e cila në bazë të kontratës së shitjes datë 21.1.2008 është tjetërsuar; 9/140 në bashkëpronësi, e cila në bazë të kontratës datë 23.1.2008 është tjetërsuar; 9/141 me sip. 2490 m² e regjistruar në datën 21.1.2008 në bashkëpronësi dhe e ndarë përkatësisht: (a) 9/145 me sip.1554 m² në bashkëpronësi dhe me kontratën datë 17.12.2012 është tjetërsuar; (b) 9/146 me sip. 861 m² e regjistruar në bashkëpronësi ku znj. L.B., ka pjesë takuese 1/6+3/15 e 1/6;
- c) certifikatat e pronësisë për pasuritë me sipërfaqe 75 m², 235 m² dhe 861 m², ku z. Petrit Çomo është bashkëpronar me 4/20, 4/20, 4/20, pjesë lëshuar datë 11.1.2019;
- d) kartelat e pasurisë dhe hartat treguese të regjistrimit të këtyre pasurive me sip. 75 m² dhe 235 m², janë të datës 11.1.2019.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se deklarimi i personit të lidhur me subjektin, nëna e tij L.B., në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është bazuar në vërtetimin e datës 12.10.2016, lëshuar nga ZVRPP-ja Mallakastër, i cili nuk pasqyron ndarjet e pasurisë përkatësisht në sipërfaqet 75 m² dhe 235 m². Veprimet administrative për ndarjen e këtyre pasurive janë bërë pas vitit 2019.

Komisioni vëren se deklarimi i personit të lidhur me subjektin përpunet me dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-Zyra Vendore Mallakastër, të administruara gjatë hetimit administrativ.

17. Llogari rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 51,000 lekë

Burim krijimi: kursime. Pjesa takuese: 100%.

Dokumentacioni bankar⁴⁷ konfirmon gjendjen e llogarisë në shumën 51,000 lekë. Në këtë llogari janë transferuar interesat e përfituara çdo vit nga depozita bankare në shumën 550,000 lekë.

Deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin bankar, të administruar gjatë hetimit administrativ.

18. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” në shumën 680 lekë

Burim krijimi: kursime. Pjesa takuese: 100%.

Dokumentacioni bankar konfirmon gjendjen e llogarisë në shumën 680 lekë. Në këtë llogari janë transferuar pagesat si dëmshpërblim për ish-të dënuarën L.B., përkatësisht në datën 2.8.2011, shuma 152,340 lekë dhe në datën 16.7.2013, shuma 152,340 lekë.

Deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin bankar, të administruar gjatë hetimit administrativ.

19. Depozitë bankare tek “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 17,165 USD

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. Pjesa takuese: 100%.

“Intesa Sanpaolo Bank”⁴⁸, me shkresën e datës 23.10.2019, konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit.

Znj. L.B., ka krijuar në “Intesa Sanpaolo Bank” në datën 15.12.2003 një depozitë me afat për periudhën 15.12.2003 – 30.8.2007. Gjendja e depozitës në datën 31.12.2003 rezulton se ka qenë në shumën 28,659.62 USD, ndërsa më 30.8.2007 është maturuar shuma 30,675.45 USD. Kjo depozitë rezulton të ketë qenë aktive deri në momentin kur znj. L.B., ka ndërruar jetë dhe në datën 24.7.2018 kjo shumë i ka kaluar në bankë subjektit të rivlerësimit.

20. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” në shumën 550,000 lekë

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. Pjesa takuese: 100%.

“Intesa Sanpaolo Bank” konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit.

Znj. L.B., ka depozituar *cash* shumën 550,000 lekë, në datën 11.1.2013 dhe ka krijuar depozitë 1-vjeçare, të rinovueshme e cila ka qenë aktive deri në momentin kur ka ndërruar jetë. Shuma e kësaj depozite, së bashku me interesat e akumuluar, është transferuar në llogarinë e subjektit si kalim i trashëgimisë në shumën 605,107 lekë, në datën 24.7.2018.

21. Depozitë bankare në “Raiffeisen Bank” të ardhura në shumën 10,589 USD

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. **Pjesa takuese:** 100%.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

“Raiffeisen Bank”⁴⁹ konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit, znj. L.B., e cila ka depozituar *cash* shumën 10,000 euro, në datën 10.10.2007 dhe ka krijuar depozitë 1-vjeçare, e cila është maturuar në datën 10.10.2008, në shumën 10,398.03 euro. Kjo depozitë rezulton të ketë qenë aktive deri në momentin kur znj. L.B., ka ndërruar jetë dhe në datën 25.7.2018 bashkë me interesat, në një total prej 10,591.25 euro i ka kaluar në bankë subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “*dëshmi trashëgimie ...*”.

22. Depozitë bankare në ICB (ish-Banka Ndërkombëtare Tregtare) në shumën 7,996 euro

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. Pjesa takuese: 100%.

“Union Bank”⁵⁰, me shkresën e datës 27.9.2019, konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit.

Znj. L.B., ka depozituar *cash* shumën 6,400 euro, në datën 6.8.2007, shumë e cila ka qëndruar deri më 7.8.2018 në llogari me interes, datë në të cilën është transferuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “kalim sipas dëshmisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2018”.

23. Depozitë në “Credins Bank” në shumën 1,693,107 lekë

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. Pjesa takuese: 100%.

“Credins Bank”⁵¹, me shkresën e datës 23.10.2019, konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit.

Znj. L.B., rezulton se ka transferuar në datën 9.8.2011, shumën 150,000 lekë nga llogaria në të cilën është përfituar dëmshpërblimi për ish të dënuarit politikë, si dhe ka transferuar nga llogaria e depozitës me nr. ***, shumën 1,090,757.81 lekë, po në datën 9.8.2011. Në datën 10.8.2013, në depozitë është shtuar shuma, nëpërmjet transferimit, 154,000 lekë me burim dëmshpërblimin për ish të dënuarën L.B. Këto shuma kanë krijuar interesa për vitet 2012 – 2016, duke mundësuar që gjendja e depozitës në datën 31.12.2016 të arrijë në shumën 1,693,107 lekë.

Më herët, llogaria e depozitës me nr. *** është krijuar nga depozitimi *cash* i shumës 850,000 lekë, në datën 2.8.2007 dhe interesat e krijuara për periudhën 2007 – 2012, duke rezultuar në datën 9.8.2011, në shumën 1,090,757.81 lekë.

24. Depozitë bankare tek “UBA” në shumën 12,997 USD

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. Pjesa takuese: 100%.

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

⁵⁰ Shkresë nr. ***, datë 27.9.2019, nga “Union Bank”. “Union Bank” në datën 1.0.2019 ka përthithur ish-Bankën Ndërkombëtare Tregtare (ICB).

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019, nga “Credins Bank”.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë⁵², me shkresën e datës 20.9.2019, konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit.

Znj. L.B., ka depozituar *cash* shumën 11,000 USD, në datën 9.10.2007, shumë e cila ka qëndruar në llogari me interes deri në datën 30.7.2018, datë në të cilën është transferuar në llogarinë bankare të subjektit me përshkrimin “transfertë në bazë të kontratës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2018”.

25. Depozitë bankare në “Veneto Bank” në shumën 12,730 euro

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. **Pjesa takuese:** 100%.

“Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën e datës 13.9.2019, konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit.

Znj. L.B., ka depozituar *cash* shumën 9,700 euro, në datën 5.10.2007, shumë e cila ka qëndruar në llogari me interes deri në datën 26.7.2018, datë në të cilën është transferuar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit për shumën 12,823.88 euro.

Gjendja e depozitës bankare në datën 31.12.2016 konfirmohet në shumën 12,730.60 euro.

26. Depozitë bankare në “Societe General Albania” në shumën 9,585 euro

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. **Pjesa takuese:** 100%.

“OTP Bank”⁵³, me shkresën e datës 23.9.2019, konfirmon gjendjen e depozitës së deklaruar nga nëna e subjektit. Kjo depozitë është hapur më 8.2.2008 me depozitimin *cash* të shumës 7,697 euro dhe është maturuar në datën 8.2.2018 për shumën 9,618.14 euro. Kjo shumë në datën 27.7.2018 është transferuar në favor të shtetasit Petrit Çomo me përshkrimin “kalim sipas aktit të trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2018”.

27. Depozitë në “Societe General Albania” në shumën 285,616 lekë

Burimi i krijimit: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. **Pjesa takuese:** 100%.

Kjo depozitë është hapur në datën 8.2.2008 me depozitimin *cash* të shumës 200,000 lekë dhe është maturuar në datën 8.2.2018, për shumën 291,224.34 lekë. Kjo shumë, në datën 27.7.2018, është transferuar në favor të shtetasit Petrit Çomo me përshkrimin “kalim sipas aktit të trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.7.2018”.

Në lidhje me depozitat bankare (referuar pikave 19-27) Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave që kanë krijuar depozitat e lartpërmendura.

⁵² Shkresa nr. *** prot., datë 20.9.2019, nga “UBA Bank”.

⁵³ Shkresa nr. *** , datë 23.9.2019, nga “OTP Bank”.

Personi i lidhur, nëna e subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi për këto depozita: të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursimeve, dëmshpërblimi si të përndjekur politikë, interesa bankare, trashëgimi nga prindërit K., e M.B., bashkëshorti M.Ç., dhe vëllai B.B.

Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me burimin e krijimit të deklaruar nga nëna e subjektit në deklaratën *Vetting*, ku të specifikohet lloji i burimit të krijimit⁵⁴, sa ka qenë pjesa përkatëse e çdo burimi në krijimin e shumave të mësipërme duke i provuar me dokumentacion këto burime.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “... kur kam plotësuar deklaratën *Vetting*, nëna ime ka qenë mbi 90 vjeç dhe e sëmurë, nuk ngrihej nga shtrati.... në këto kushte në deklaratën *Vetting* për nënën janë shënuar të dhëna sipas deklarimeve të saj dhe sipas dokumenteve që kam pasur mundësi të kem në dispozicion. Nëna ime ka lindur në një familje të pasur... Pasuritë e saj i ka administruar vetë dhe të gjitha paratë që ka pasur nëpër banka i ka depozituar vetë.

*Deklarimi se burimi i krijimit të shumave të depozituara prej saj në banka të ndryshme kanë qenë të ardhura nga 'kthimi i pronave, shitja e pronave, kursime, dëmshpërblim si i përndjekur politik, interesat bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B.,' është i asaj. Ajo nuk mund të përcaktonte se sa ishte pjesa përkatëse e çdo burimi, ky ka qenë deklarimi i saj. Të gjitha dokumentet që kishte në dispozicion janë dorëzuar në ILDKPKI kur kam plotësuar deklaratën *Vetting*. Nuk është e mundur për mua të përcaktoj saktësisht se sa është pjesa përkatëse e çdo burimi të krijimit të pasurisë. Di vetëm që gjithmonë kur shiteshin prona, mamaja dhe vëllezërit e saj, nëna ime i depozitonte paratë në bankë. Këto veprime i kryente vetë dhe unë nuk kam pasur dijeni për shumat e përfutuara nga shitjet apo nga burimet e tjera dhe as për ato të depozituara në bankë prej saj. Nëna ime ka përfutuar pasuri edhe nga pagesa për pensionet pasi kur ka qenë e internuar e paguanin me pension minimal për faktin se ishte e përndjekur kur sipas ligjit duhej të merrte pension të lartë. Ky fakt provohet me vendimin e gjykatës nr. ***, datë 25.7.1997 dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë nr. ***, datë 24.9.1997, si dhe me vendimin nr. ***, datë 12.2.1998, të Gjykatës së Lartë, ku rezulton se nëna ime ka përfutuar nga ISSH-ja shumën 454,650 lekë... Nëna ime ka pasur shumë udhëtime nëpër vende të ndryshme të Europës ku të gjitha këto udhëtime janë mbuluar nga personat që e kanë ftuar...”*

Pas kalimit të barrës së provës, me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

- nuk ka deklaruar në deklaratat e pasurisë për vitet 2003 - 2004, depozitën e krijuar nga personi i lidhur, nëna e tij, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 28,659.62 USD, e cila më pas ka shërbyer si burim krijimi për depozitën në shumën 17,165 USD;
- subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të depozitave bankare në emër të personit të lidhur, nënës së tij.

Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet e datës 27.7.2020, ka shpjeguar se:

- Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat e pasurisë së viteve 2003-2004 llogaritë bankare të personit të lidhur, nënës së tij, subjekti ka shpjeguar se një llogari bankare nuk mund të fshihet dhe se objekti i hetimit dhe i rivlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit është deklarimi në deklaratën *Vetting*, në të cilën deklarohen vetëm ato sende të luajtshme dhe të paluajtshme që ekzistojnë ditën që

⁵⁴ Nga burimet e sipërpërmendura.

plotësohet kjo deklaratë, jo pasuri që janë shpenzuar apo detyrime që kanë ekzistuar, por që nuk ekzistojnë më.

- Nëna e tij pas vitit 2005 nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe të ardhurat e saj i ka administruar personalisht. Subjekti deklaroi se asnjëherë nuk ka depozituar në ndonjë bankë, para në emër të saj. Kur është përpiluar deklarata *Vetting* në janar të vitit 2017, nëna e tij ka qenë mbi 90 vjeç dhe e sëmurë. Në këto kushte, sipas deklarimit të saj si pasuri janë shënuar ato që ajo mbante mend, pra të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursime, dëmshpërblim si e përndjekur politike, interesat bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B.

Siç ka deklaruar subjekti: “... kur shiteshin prona, me të cilat kryesisht merrej vëllai i saj tashmë i vdekur, P.B., nëna e subjektit dhe vëllezërit e saj i ndanin paratë dhe ajo i depozitonte në bankë. Paratë e trashëguara kanë qenë prej vitesh në banka dhe nuk di të ketë pasur ndonjëherë probleme për depozitimin e shumave në bankë”.

Subjekti deklaroi se ka gjetur dhe dorëzoi disa kontrata shitje pronash si:

- kontratë shitblerjeje truall nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.1999, sipas së cilës rezultoi se nëna e tij dhe vëllezërit e saj kanë shitur një truall me sip. 70 m², në shumën 200,000 lekë;
- kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2004, sipas së cilës rezultoi se nëna e tij dhe vëllezërit e saj kanë shitur një banesë dhe truallin e saj në shumën 1,147,500 lekë;
- në kuadër të deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur edhe kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2000, sipas së cilës rezultoi se nëna e tij dhe vëllezërit e saj kanë shitur një truall në shumën 250,000 lekë;
- në kuadër të deklaratës *Vetting* subjekti ka paraqitur edhe kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2001, sipas së cilës rezultoi se nëna e tij dhe ai kanë shitur një banesë që ndodhet në Rr. “****” Tiranë, në shumën 3,600,000 lekë;
- ka dorëzuar gjithashtu edhe vendimin nr. ***, datë 25.7.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata e Lartë, sipas të cilit rezultoi se nëna e tij ka përfituar nga ISSh-ja shumën 717,956 lekë, provuar ky fakt edhe me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2020, të DRSSh-së Tiranë.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se në lidhje me mosdeklarimin e depozitës së krijuar nga nëna e tij në shumën 28,659.62 USD në vitin 2003, nga e cila më pas është krijuar depozita prej 17,165 USD, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* depozitën prej 17,165 USD si një pasuri të luajtshme që ka ekzistuar në momentin e plotësimit të deklaratës, ndryshe nga depozita prej 28,659.62 USD, e cila ka ekzistuar në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

Konkluzion

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me mosdeklarimin e depozitës së krijuar nga nëna e tij në vitin 2003, si dhe ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të krijimit të depozitave nga personi i lidhur me të, nëna e tij.

28. Gjendje cash në banesë në shumën 1,400,000 lekë

Burimi i krijimit: nga shitja e pronave dhe kursime.

Në analizën financiare kursimet në shumën 1,400,000 lekë janë marrë në konsideratë si pasuri e krijuar në vitin 2016, pasi subjekti nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat, detyrimet dhe pasuritë e krijuara në emër të nënës në deklaratat periodike vjetore.

Komisioni, në lidhje me gjendjen *cash* në shumën 1,400,000 lekë, ka konstatuar se:

Referuar analizës financiare për vitin 2016⁵⁵, subjekti dhe personi i lidhur me të, nëna e tij, nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën 304,132 lekë për të krijuar kursimet dhe për të mbuluar shpenzimet pasi ky vit ka rezultuar me balancë negative.

Me kalimin e barrës së provës subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

Së pari – analiza financiare për vitin 2016 është e pasaktë edhe nëse do të konsiderohej se shuma prej 1,400,000 lekësh do të merrej se është kursyer nga nëna e subjektit në vitin 2016 dhe jo ndër vite (2005 – 2016). Në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë shumën 300.000 lekë, ndërsa nëna e tij në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendje *cash* vlerën 1,400,000 lekë dhe si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar “të ardhura nga shitja e pronave, kursime”. Subjekti shpjegon se kursimet e nënës nuk lidhen vetëm me një vit, por me gjithë jetën e saj.

Pra, duke mbledhur gjendjen *cash* në banesë rezulton një shumë prej 1,700,000 lekësh dhe balanca financiare është pozitive 2,398,357 lekë -1,700,000 lekë = 698, 357 lekë. Subjekti thekson, siç e ka përmendur edhe më lart se shuma 1,400,000 lekë është nga kursimet e nënës së tij të paktën për vitet 2005 – 2016, pra më shumë se 10 vjet.

Së dyti – subjekti sqaron se nëna e tij nuk ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë, të ardhurat e saj i ka administruar vetë. Ai asnjëherë nuk ka depozituar para në emër të saj në ndonjë bankë. Kur është përpiluar deklarata *Vetting* në janar të vitit 2017, nëna tij ka qenë mbi 90 vjeç dhe e sëmurë. Në këto kushte, sipas deklarimit të saj si pasuri janë shënuar ato që ajo mbante mend, pra të ardhura nga kthimi i pronave, shitja e pronave, kursime, dëmshpërblim si e përndjekur politike, interesat bankare, trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., vëllai B.B. Kur shiteshin prona, me të cilat kryesisht merrej vëllai i saj tashmë i vdekur, P.B., nëna e subjektit dhe vëllezërit e saj i ndanin paratë dhe ajo i depozitonte në bankë. Paratë e trashëguara kanë qenë prej vitesh në banka.

Subjekti ka depozituar disa kontrata shitje pasurish të paluajtshme si:

- kontratë shitblerjeje trualli nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.1999, ku nëna dhe vëllezërit e saj kanë shitur një truall me sip. 70 m², në shumën 200,000 lekë;
- kontratë shitjeje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2004, ku nëna dhe vëllezërit e saj kanë shitur një banesë dhe truallin e saj në shumën 1,147,500 lekë;
- në kuadër të deklaratës *Vetting* ka paraqitur edhe kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2000, ku nëna dhe vëllezërit e saj kanë shitur një truall në shumën 250,000 lekë;
- në kuadër të deklaratës *Vetting* ka paraqitur edhe kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2001, ku nëna dhe subjekti kanë shitur një banesë në shumën 3,600,000 lekë, e cila ndodhet në Rr. “*****” Tiranë;
- ka dorëzuar gjithashtu edhe vendimin nr. ***, datë 25.7.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata e Lartë, sipas të cilit rezulton se

⁵⁵ Shihni analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, në f. 50-57.

nëna tij ka përfituar nga ISSh-ja shumë 7,179,56 lekë, provuar ky fakt edhe me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2020, të DRSSh-së Tiranë.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se subjekti ka argumentuar diferencën financiare negative të vitit 2016 si rezultat i llogaritjes së kursimeve *cash* të deklaruara nga nëna e tij në deklaratën *Vetting* në shumë 1,400,000 lekë si kursime të krijuara vetëm në vitin 2016, ndërkohë që këto kursime janë të krijuara ndër vite.

Komisioni vlerëson të pranueshëm faktin e pamundësisë së subjektit për të dhënë informacion të plotë e qartë për shpërndarjen e kursimeve *cash* nga nëna e tij pasi ajo nuk jeton më. Subjekti nuk kishte informacion në lidhje me mënyrën se si nëna e tij kishte administruar kursimet e saj, pasi ajo ishte marrë vetë me këtë proces. I ndodhur në këto kushte, marrë shkas edhe nga fakti se nëna e subjektit, referuar formularëve të deklarimit të pasurisë për periudhën 2003 –2016 nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë pasurinë, pasi në formularin e deklarimit deklaroheshin vetëm të ardhurat e bashkëshortes/bashkëjetueses (shtuar më vonë) dhe të fëmijëve, Komisioni bëri shpërndarjen e kursimeve *cash* të nënës së subjektit për periudhën 2003 – 2016, në mënyrë të tillë që shtesa e kursimeve *cash* të ndiqte ecurinë e rritjes së të ardhurave nga pensioni. Personi i lidhur me subjektin, nëna e tij, ka përfituar vlera të konsiderueshme nga pensioni pasi ajo është trajtuar njëkohësisht me pension pleqërie dhe pension invalid luftime gjatë të gjithë periudhës së hetimit të kryer për subjektin.

29. Shitje truall me sip. 348 m² shtetasit A.B., me kontratën nr. * rep., nr. *** kol., datë 23.1.2008, në shumë 600,000 lekë**

Pjesa takuese: 1/6+3/15 e 1/6.

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes datë 23.1.2008⁵⁶ me shitës shtetasit L., F., P., A., S., L., K., D.B., dhe blerës A.B., me objekt shitjen e truallit me sip. 348 m² në Ballsh, Mallakastër me çmimin 600,000 lekë. Znj. L.B., zotëron 1/6+3/15 e 1/6 pjesë.

ASHK-ja, në përgjigje të saj drejtuar Komisionit me nr. *** prot., datë 15.10.2019, nuk ka dërguar informacion për pasuritë e transkriptuara të personit të lidhur me subjektin, por vetëm informacion në lidhje me pasuritë aktuale.

ASHK-ja, me shkresën datë 12.10.2016 (vërtetim lëshuar subjektit), ka konfirmuar se pasuria e llojit truall me sip. 3168 m² është ndarë në pasurinë 9/139 e llojit truall me sip. 348 m², e cila sipas kontratës së shitjes së datës 21.1.2008 me shitës (7 bashkëpronarët B., + L.B.) ka kaluar në pronësi të shtetasit A.B., kundrejt çmimit 600,000 lekë.

Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në shumë 600,000 lekë për pjesën takuese (1/6+3/15 e 1/6) ose 1/5 është 120,000 lekë (600,000 lekë x 1/5).

Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të ardhurat për pjesën takuese të nënës së subjektit në 1/5 që i përket vlerës 120,000 lekë.

Deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti dhe ASHK-ja, të administruara gjatë hetimit administrativ.

⁵⁶ Kontratë shitjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2008.

30. Shitje truall me sip. 330 m² shtetasit H.A., me kontratën nr. * rep., nr. *** kol., datë 23.1.2008, në shumën 500,000 lekë**

Pjesa takuese: 1/6+3/15 e 1/6.

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së datës 23.1.2008⁵⁷ me shitës shtetasit L., F., P., A., S., L., K., D.B., dhe blerës shtetasin H.A., me objekt shitjen e truallit me sip. 330 m² në Ballsh, Mallkastër me çmimin 500,000 lekë.

Nëna e subjektit, znj. L.B., zotëron 1/6+3/15 e 1/6 pjesë.

ASHK-ja, në përgjigje të saj drejtuar Komisionit me nr. *** prot., datë 15.10.2019, nuk ka dërguar informacion për pasuritë e transkriptuara të personit të lidhur me subjektin, por vetëm informacion në lidhje me pasuritë aktuale.

ASHK-ja, me shkresën datë 12.10.2016 (vërtetim lëshuar subjektit), ka konfirmuar se pasuria e llojit truall me sip. 3168 m² është ndarë në pasurinë 9/140 të llojit truall me sip. 330 m², e cila sipas kontratës së shitjes së datës 23.1.2008 me shitës 7 bashkëpronarët B., + L.B., ka kaluar në pronësi të z. H.A., kundrejt çmimit 500,000 lekë.

Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në shumën 500,000 lekë për pjesën takuese (1/6+3/15 e 1/6) ose 1/5 është 100,000 lekë (500,000 lekë x 1/5).

Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të ardhurat për pjesën takuese të nënës së subjektit në 1/5 që i përket vlerës 100,000 lekë.

Deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti dhe ASHK-ja, të administruara gjatë hetimit administrativ.

31. Shitje truall me sip. 1554 m² shtetasit S.J., me kontratën nr. * rep., nr. *** kol., datë 17.12.2012, në shumën 2,727,000 lekë**

Pjesa takuese: 1/6+3/15 e 1/6.

Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes së datës 17.12.2012⁵⁸ me shitës shtetasit L., F., P., A., S., L., K., D.B., dhe blerës shtetasin S.J., me objekt shitjen e truallit me sip. 1554 m² në Ballsh, Mallkastër me çmimin 2,727,000 lekë. Nëna e subjektit, znj. L.B., zotëron 1/6+3/15 e 1/6 pjesë.

ASHK-ja, në përgjigje të saj drejtuar Komisionit me nr. *** prot., datë 15.10.2019, nuk ka dërguar informacion për pasuritë e transkriptuara të personit të lidhur me subjektin, por vetëm informacion në lidhje me pasuritë aktuale.

ASHK-ja, me shkresën datë 12.10.2016 (vërtetim lëshuar subjektit), ka konfirmuar se pasuria e llojit truall me sip. 3168 m² është ndarë në pasurinë 9/145 e llojit truall me sip. 1554 m², e cila sipas kontratës së shitjes të datës 17.12.2012 me shitës 7 bashkëpronarët B., + L.B., ka kaluar në pronësi të z. S.J., kundrejt çmimit 2,727,000 lekë.

Komisioni i ka kërkuar subjekti me pyetësorin nr. 2 që të provojë me dokumentacion ligjor se si janë përfituar këto dy pasuri të tjetërsuara nga nëna e tij L.B., dhe vëllezërit e saj.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: *"... këto prona kanë qenë të gjyshit K.B., dhe me këto prona që në vitet '90 është marrë nëna dhe vëllai i saj P.B. Më pas nëna nuk ishte në gjendje për*

⁵⁷ Kontratë shitjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2008.

⁵⁸ Kontratë shitjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2012.

t'u interesuar për shkak të gjendjes shëndetësore dhe më pas u mor daja P.B. Unë nuk jam marrë me pronat e familjes. Këto prona, gjyshi im K.B., i ka pasur në Mallakastër dhe i ka marrë sipas ligjit me vendime të KKK Pronave të kohës, si dhe me vendime gjyqësore”.

Subjekti ka depozituar: (i) vendimin gjyqësor të datës 16.5.1996, ku gjykata ka pranuar padinë e trashëgimtarëve B., kundër vendimit nr. 107, datë 21.1.1996, të KKKP-së, duke i njohur si pronarë mbi sipërfaqet e truallit prej 9800 m², 3573 m² (truall i lirë 2760 m², 173 m² dhe truall i zënë me ndërtime 27 m², 290 m² dhe 323 m²), iu kompensuan 6227 m²; (ii) kontratat e shitjes së pasurive truall 330 m² H.A., 348 m² A.B., dhe 1554 m² S.J.

Të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në shumën 2,727,000 lekë për pjesën takuese (1/6+3/15 e 1/6) ose 1/5 është 545,400 lekë (2,727,000 lekë x 1/5).

Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të ardhurat për pjesën takuese të nënës së subjektit në 1/5, që i përket vlerës 545,400 lekë.

Deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe nga ASHK-ja, të administruara gjatë hetimit administrativ.

32. Shitje banese e vëllait të trashëgimlënësës, z. B.B., e 1/5 së vlerës, në *, Durrës**

Nëna e subjektit ka deklaruar se: *“Kontratën nuk e disponoj pasi nuk gjendet, veprimet i ka bërë vëllai i vdekur P.B.,”.*

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë⁵⁹ ka konfirmuar se nuk rezulton të kenë pasuri të deklaruara të regjistruara apo të tjetërsuara në emër të shtetasve L.B., dhe Petrit Çomo.

Komisioni, fillimisht, në lidhje me këtë deklaram ka konstatuar se nuk ka dokumentacion provues dhe nuk është përcaktuar shuma e përfituar dhe, për këtë arsye, nuk mund të merret në konsideratë në analizë financiare.

Pas kalimit të barrës së provës si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e porosisë datë 8.5.2002⁶⁰ me sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe porositës shtetasin B.B., për ndërtimin e një vile njëkatëshe me sip. 82 m², në Golem, me çmimin 29,000 USD.

Në datën 19.1.2007, shtetasi B.B., ka ndërruar jetë dhe me vendimin nr. ***, datë 20.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë së tij duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë shtetasit L., F., P.A.B., (motra dhe vëllezërit) me nga 3/15 pjesë dhe shtetaset S., L., dhe D.B., (mbesat) me nga 1/15 pjesë.

Me deklaratën noteriale datë 26.12.2007⁶¹ trashëgimtarët L.B., etj., shoqëria “****” sh.p.k. si sipërmarrës deklarojnë se heqin dorë nga nëdörösia e vilës në Golem sipas kontratës së sipërmarrjes dhe ia dorëzojnë z. S.B., i cili i ka likuiduar me shumën 37,000 euro. Edhe shoqëria “****” sh.p.k. është dakord që marrëdhëniet në lidhje me vilën në vijim do të jenë më shtetasin S.B.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komision vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues që në lidhje me banesën në Golem nëna e tij L.B., ka përfituar të ardhura nga shitja e saj.

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2020, nga ASHK-Drejtoria Vendore Kavajë.

⁶⁰ Kontrata e porosisë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.5.2002, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit dhe z. B.B., në cilësinë e porositësit.

⁶¹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.12.2007.

Rezultoni e provuar se vëllai i znj. L.B., B.B., ka përfituar një vilë në Golem nga një kontratë sipërmarrjeje e datës 8.5.2002.

Pasi z. B.B., ka ndërruar jetë në vitin 2007, trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë janë përcaktuar znj. L.B., etj., me pjesë 3/15.

Me deklaratën noteriale të datës 26.12.2007, trashëgimtarët e z. B.B., ku përfshihet dhe znj. L.B., e kanë shitur vilën me çmimin 37,000 euro. Nga shitja e kësaj pasurie pjesa takuese e znj. L.B., është 7,400 euro (3/15 e 37,000 euro).

Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues për pagesën e tatimit për të ardhurat nga shitja e vilës në Golem në shumën 37,000 euro dhe në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat e njohura nga Komisioni janë në shumën 29,000 USD. Pjesa takuese e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit është 3/15.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka depozituar prova për shitjen e ndërtesës në Golem dhe në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës e ardhura e ligjshme është konsideruar në shumën 5,800 USD (1/5 e 29,000 USD).

33. Shitje apartament banimi e vëllait të trashëgimtarës, B.B., Tiranë, e 1/5 së vlerës

Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. L.B., në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se: “Kontratën nuk e disponoj pasi nuk gjendet, veprimet i ka bërë vëllai i vdekur P.B.,”.

ASHK-ja Tiranë⁶² nuk ka konfirmuar pasuri të paluajtshme në emër të z. B.B., me vendndodhje në “****”.

Komisioni në lidhje me këtë deklaram ka konstatuar se:

- nuk ka dokumentacion provues në lidhje me këtë deklaram, si dhe nuk është përcaktuar shuma, për këtë arsye nuk mund të merret në konsideratë në analizë financiare.

Në lidhje me këtë konstatim, pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka depozituar kontratën e shitjes datë 26.9.2007⁶³ me shitës shtetasit L.B., etj. dhe blerës shtetasin F.M., për apartamentin me sip. 55.3 m² me adresë: Rruga e ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, me vlerën 1,900,000 lekë.

Po kështu edhe nga certifikata për vërtetim pronësie e datës 23.8.2007 për apartamentin me sip. 55.3 m², konfirmohet bashkëpronësia e shtetasve L.B., etj., ku znj. L.B., rezulton bashkëpronare për 3/15 pjesë.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komision vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me apartamentin te Rruga e *** dhe se nëna e tij, znj. L.B., ka përfituar të ardhura nga shitja e tij.

Rezultoni e provuar nga certifikata për vërtetim pronësie e datës 23.8.2007, bashkëpronësia e znj. L.B., me 3/15 pjesë të kësaj pasurie.

Rezultoni se me kontratën e shitblerjes së datës 26.9.2007, ky apartament i është shitur shtetasit F.M., në shumën 1,900,000 lekë, nga ku znj. L.B., ka përfituar shumën prej 380,000 lekësh (3/15 e 1,900,000 lekë).

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2019, nga ASHK-Tirana Jug; shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2019, nga Tirana-Veri; shkresë nr. ***, datë 14.10.2019, Rurale 1; shkresë nr. *** prot., datë 22.10.2019, nga Tirana Rurale 2.

⁶³ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2007 me shitës L.B., etj. dhe blerës F.M.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka depozituar prova të plota duke provuar burimin e ligjshëm të shumës së përfituar nga shitja e apartamentit të “Rruga e ***” në shumën 380,000 lekë, e cila është marrë në konsideratë nga Komisioni, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin D të Kushtetutës.

34. Shitje e një dhome, në pallatin e ndërtuar në truallin ku znj. L.B., është bashkëpronare, shtetasit L.G., me kontratë shitjeje nr. * rep., nr. *** kol., datë 18.10.2001**

Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 1/6.

Subjekti ka depozituar kontratën e shitjes datë 18.10.2001⁶⁴, bashkëngjitur dhe vërtetimi hipotekor datë 2.10.2001, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, me shitës shtetasit L., F., F., A., dhe P.B., dhe blerës shtetasi L.G., për pasurinë në katin përdhës me sip.13.2 m², me vlerë 100,000 lekë.

Komisioni ka kërkuar nga subjekti të shpjegojë se si është përfituar pasuria me sip. 13.2 m², e cila i është shitur më pas shtetasit L.G.

Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka depozituar në Komision dokumentacionin:

- vendimin nr. ***, datë 14.8.1995, të KKK Pronave, i cili u nje trashëgimtarëve të z. K.B., pronësinë e truallit me sip. 187 m²;
- kontratën e sipërmarrjes datë 16.6.2000 me sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe porositës trashëgimtarët B., etj., për ndërtimin e një pallati ***-katësh, duke i vënë në dispozicion ndërtuesit truallin me sip. prej 178 m²;
- aktpjesëtimi i datës 26.9.2001, ku trashëgimtarët B., ndër të tjera, bien dakord që znj. L.B., i takon apartamenti me sip. 91.2 m², nr. ***, k. ***, si dhe në bashkëpronësi me vëllezërit me pjesë të barabarta ajo ka dhe një dhomë me sip. 13.2 m² në katin ***, një dhomë+ballkon me sip. 18.2 m², në katin e *** dhe një dhomë+ballkon me sip. 17.8 m², në katin e ***;
- vërtetim hipotekor nga ZRVPP-ja Tiranë i datës 24.9.2001, ku në emër të shtetasve L.B., etj., janë regjistruar pasuritë, ku përfshihet dhe dhomë në katin *** me sip. 13.2 m².

Deklarimi i personit të lidhur me subjektin përputhet me dokumentacionin e depozituar nga subjekti, të administruar gjatë hetimit administrativ.

35. Trashëgimi nga prindërit K., dhe M.B., bashkëshorti M.Ç., dhe vëllai B.B.,

Vlera: nuk mund të llogaritet.

36. Të ardhura nga kthimi i pronave dhe nga shitja e një pjese të tyre

Vlera: nuk mund të llogaritet (kryesisht me pronat është marrë i vëllai, P.B., i cili ka ndërruar jetë).

Subjekti, për deklaratimet në pikat 35 dhe 36, nuk ka përcaktuar në mënyrë konkrete edhe dokumentacionin justifikues ligjor përkatës dhe, për këtë arsye, Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë në analizën financiare.

KONSTATIME TË TJERA

37. Kontratë shkëmbimi, datë 28.9.2001,⁶⁵ nga palët F., F., A., P., dhe L.B., bashkëpronarë të një trualli të lirë me sip. 401 m² dhe shoqërisë “**” sh.p.k. përfaqësuar nga shtetasi B.K., të cilët këmbëjnë apartamentet e ndërtuara me këtë truall me specifikimet përkatëse. Znj. L.B., si**

⁶⁴ Kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2012.

⁶⁵ Kontrata e shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.9.2001.

bashkëpronare me 1/6 pjesë të pandarë do të kompensohet në një pallat tjetër në masën që i takon.

Subjekti ka depozituar kontratën e mësipërme për efekt të procesit të rivlerësimit në ILDKPKI.

ASHK-ja, Tirana Jug ka konfirmuar pasurinë me sip. 401 m² truall, të ndodhur në z. k. ***, Tiranë në emër të shtetasve A., B., F., F., P., dhe L.B., të përfituar me vendim të KKK Pronave, Tiranë me statusin “e mbyllur”.

KKK Pronave Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 5.11.1996, ka vendosur kompensimin e trashëgimtarëve të ish-pronarit K.B., të cilët trashëgojnë 1/6 e pasurive trashëgimore, me sip. 401 m².

Në kontratën e shkëmbimit, datë 28.9.2001, lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit P.B., si përfaqësues i trashëgimtarëve B., në një pjesë të saj përcaktohet se: “...*bashkëpronarja me 1/6 pjesë të pandarë L.B., do të kompensohet në pallat tjetër me apartament në masën që i takon ...*”.

Komisioni ka konstatuar se subjekti ka depozituar një kontratë shkëmbimi, por nuk ka dhënë shpjegime se cila pasuri është përfituar apo këmbyer me këtë kontratë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka shpjeguar se nuk rezulton që nga kjo kontratë nëna e tij të ketë përfituar ndonjë pasuri dhe se nuk ka dijeni që nëna të ketë fituar ndonjë pasuri nga kjo kontratë dhe se nuk disponon ndonjë dokument tjetër ligjor përveç kësaj kontrate.

Komisioni ka kryer edhe korrespondencë me shoqërinë “****” sh.p.k., ku i ka kërkuar marrëveshje/kontrata që mund të kenë lidhur shtetasit L.B., dhe Petrit Çomo me këtë shoqëri, vlerën e këtyre pasurive, detyrime nëse kanë dhe dokumentacion tjetër të pagesave etj.

Shoqëria “****” sh.p.k. ka dërguar në Komision dy kontrata: (i) kontratën e sipërmarrjes së datës 14.9.1999⁶⁶ me porosites trashëgimtarët B., përfaqësuar me prokurë nga vëllai P.B., dhe sipërmarrës shoqërinë “****” sh.p.k., të cilët porositesit e kanë revokuar dhe lidhën marrëveshje më pas me shoqërinë “****” sh.p.k.; (ii) kontratën e sipërmarrjes së datës 19.7.2000⁶⁷ ndërmjet pronarëve të truallit të trashëgimtarëve B., të përfaqësuar me prokurë nga z. P.B., dhe sipërmarrësit të shoqërisë “****” sh.p.k.

Komisioni ka hetuar edhe mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe administratorin e saj z. B.K., dhe nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁸ nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni dhe provat e administruara nuk rezultoi që nëna e subjektit, znj. L.B., të jetë përfituese e ndonjë pasurie të paluajtshme nga marrëdhënia e sipërmarrjes dhe e shkëmbimit me shoqërinë “****” sh.p.k.

38. Truall me sip. 225 m², nr. pasurie *, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Tiranë, nuk rezulton në emër të subjekteve (L.B., dhe Petrit Çomo), ka pësuar transaksion**

⁶⁶ Kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.1999.

⁶⁷ Kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2000.

⁶⁸ Përgjigja nr. *** prot., datë 8.1.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana-Jug⁶⁹ konfirmon pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. *** të llojit “truall” me sip. 225 m² me shënimin (nuk figuron në emër të subjekteve, ka pësuar transaksion). Kartela e pasurisë e pasqyron këtë pasuri me pronar “Shtet”.

Nga dokumentacioni i përcjellë, trualli me sip. 225 m² me vendndodhje Selitë e Vogël, Tiranë, është përfituar nga kontrata e shitjes e datës 31.7.1992, me shitës Komiteti Ekzekutiv i Rajonit nr. 2 dhe blerës shtetasin Petrit Çomo për çmimin 13,500 lekë.

Për zhvillimin e kësaj pasurie, Komiteti Ekzekutiv (seksioni i urbanistikës) i ka lëshuar shtetasit Petrit Çomo lejen e ndërtimit nr. ***, datë 30.7.1992, për ndërtimin e një banese vetjake.

Me kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.11.1996 subjekti ia ka dhuruar këtë truall pranuesit të dhurimit z. A.Sh.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me arsyen e dhurimit si dhe njohjen me shtetasin A.Sh., si dhe pse kjo pasuri vijon ende në pronësi “shtet” në ZVRPP.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka shpjeguar se: “... në fund të vitit 1991 dhe fillim të vitit 1992 u interesova të blija një truall nga shteti për të ndërtuar një shtëpi private. Pasi kreu procedurat përkatëse, e bleva truallin me kontratë shitje nga KE i rajonit 2, Tiranë për një shumë rreth 15,000 lekë dhe me sa mbaj mend e regjistrova në hipotekë. Prona ndodhej në Selitë të Vogël Mbjaj mend që me disa punëtorë kam hapur një pjesë të themeleve. Meqë në atë kohë kisha filluar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, si dhe sapo kisha filluar punë në ish-Kinostudio dhe për këtë arsye nuk kisha kohë dhe as mundësi ekonomike të merresha me ndërtimin e shtëpisë. Pas disa vitesh, mendoj në muajin nëntor 1996 kam shkuar për të parë truallin e lartpërmendur dhe pashë se kishte filluar ndërtimi i një banese. Kam pyetur dhe ka ardhur një person për të cilin më pas mësova se quhej A.Sh.,... Ata më thanë se këtë truall ua kishin blerë disa personave të tjerë dhe ishin ata pronarë trualli dhe meqë ata e pretendonin këtë gjë u takuam pas disa ditësh ku ballafaquam dokumentet... Sipas tyre truallin ua kishin shitur disa persona që i kishin mashtruar dhe ranë dakord se pronari i truallit isha unë. A., me babanë e tij thanë se i kishin marrë borxh paratë që kishin blerë truallin nga persona të tjerë, po e ndërtonin banesën me vështirësi, kishin disa halle familjare dhe më kërkuan që t’ia dhuroja truallin duke përfituar nga fakti se unë nuk kisha ndërmend të ndërtoja, si dhe nga fakti që trualli ishte blerë me një çmim modest. Duke pasur parasysh ngjarjet e vitit 1997, si dhe si pasojë që mendoja dhe unë si të tjerë të largohesha nga Shqipëria pranova kërkesën e tyre dhe i dhurova truallin A.,... ”.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe ka paraqitur dokumentacion të plotë në lidhje me historikun e kësaj pasurie, që me blerjen e saj nga subjekti, punimet minimale të kryera mbi të nga subjekti, zaptimin e saj nga persona të tjerë dhe dhurimin e saj personave që kishin filluar të ndërtonin shtëpi. Kjo pasuri nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit për shkak të vlerës simbolike dhe të kohës kur është blerë dhe tjetërsimin e saj nëpërmjet procedurës së dhurimit, pra, pa efekt financiar.

Analiza financiare

Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ne Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhëna në deklaratimet periodike vjetore pranë ILDKPKI-së, deklaratës *Vetting*, informacioneve të ardhura

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 15.10.2019, nga ASHK-ja.

nga institucionet përkatëse dhe deklaramet e subjektit. Z. Petrit Çomo ka qenë subjekt deklarimi pa ndërprerje që prej vitit 2003.

Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare është bazuar në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklarata *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar 2003 – 2016 bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe honoraret në vlerë *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁷⁰, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Për të ardhurat nga pensioni për periudhën 1981 – 2016 janë marrë në analizë të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit, znj. L.B., si pension pleqërie, pension invalidi lufte dhe pension i posaçëm sipas vërtetimit nga ISSh-ja⁷¹, si edhe vendimit të Gjykatës⁷².

Për të ardhurat në formën e interesave bankare të depozitave janë marrë në analizë vlerat sipas nxjerrjes së llogarisë bankare, për depozitat e të cilave është provuar burimi i ligjshëm.

Për të ardhurat nga shitja e pasurive të luajtshme (automjete) janë marrë në konsideratë vlerat sipas kontratave⁷³.

Për të ardhurat në formën e trashëgimisë janë marrë në analizë vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratat e interesave pasurore pasi është provuar burimi i ligjshëm i tyre.

Për të ardhurat nga qiraja janë marrë në konsideratë vlerat për të cilat ka pasur kontratë dhe për të cilat është vërtetuar pagesa e tatimit në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Për të ardhurat nga dëmshpërblimet si të përndjekur politikë janë marrë në konsideratë vlerat sipas shumave të transferuara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij.

Lidhur me shpenzimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarameteve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë:

- Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Për vitin 2007, konsumi për frymë është marrë sa

⁷⁰Vërtetim datë 1.11.2016 nga Gjykata e Rrethit Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 13.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim nr. *** prot., datë 11.1.2017, nga KLD-ja.

⁷¹Vërtetim nr. *** prot., datë 7.01.2020, nga ISSh-ja.

⁷²Vendimin e gjykatës nr. ***, datë 25.7.1997, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë nr. ***, datë 24.9.1997, si dhe me vendimin e Gjykatës së Lartë nr. ***, datë 12.2.1998, ku rezulton se nëna e subjektit ka përfituar nga ISSh-ja shumën 454,650 lekë.

⁷³ Kontrata e datës 20.12.2013 për shitjen e automjetit tip "Benz A Class 170" me çmimin 4,000 euro.

shpenzimi i llogaritur për vitin 2008, në vlerën 136,620 lekë. Për periudhën 2003 – 2016 shpenzimet jetike janë llogaritur për familje me 2 anëtarë.

- Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalëse nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit të dhëna në pyetësonin nr. 1.

Llogaritja e shpenzimeve bazohet në deklarinimin e subjektit të rivlerësimit në pyetësonë, pasi këto vlera të deklaruara prej tij nuk cenojnë standardin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019.

Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, për të cilat kanë vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion justifikues ligjor për mbulimin e këtyre shpenzimeve.

- Shpenzimet e mobilimit janë marrë në analizë në vlerën 0 lekë, pasi subjekti ka deklaruar se nuk ka banuar asnjëherë në shtëpinë e tij, të cilën e ka dhënë me qira, të pamobiluar. Subjekti deklaron se ka jetuar në shtëpinë e nënës së tij.

Lidhur me pasuritë e krijuara dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore. Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* të akumuluar përputhen me gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve.

Likuiditetet (*cash*, bankë) janë regjistruar në një nënkategori të pasurisë “Kursime (Pakësim/Shtesa likuiditeti)”. Në këtë kategori kemi pasqyruar ndryshimin e zërit likuiditete, pra, shtesën osë pakësimin e ndodhur gjatë vitit përkatës në likuiditete.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Likuiditete cash	63.195	131.645	204.058	286.122	373.144	467.056	569.098	675.274	785.766	901.697	1.022.317	1.146.014	1.271.916	1.700.001
Likuiditete bankë	4.206.331	6.048.141	5.168.432	5.824.836	8.932.896	11.071.655	12.026.432	14.196.179	15.580.901	17.307.082	19.110.315	19.528.791	20.695.530	21.691.764
Likuiditete Total (cash + bankë)	4.269.526	6.179.786	5.372.491	6.110.958	9.306.040	11.538.711	12.595.530	14.871.454	16.366.667	18.208.779	20.132.633	20.674.805	21.967.446	23.391.765
Ndryshim likuiditete (Gjendje likuiditete vitit - Gjendje likuiditete vitit paraardhës)	-3,121,418	1,910,259	-807,295	738,467	3,195,082	2,232,671	1,056,819	2,275,923	1,495,214	1,842,112	1,923,853	542,173	1,292,641	1,424,319

Lidhur me pasuritë e luajshme dhe të paluajshme të krijuara për periudhën 2003 – 2016, janë marrë në konsideratë vlerat e tyre referuar kontratave të shitblerjes, dokumentacionit mbështetës

si fatura të blerjes⁷⁴, deklarata doganore⁷⁵ dhe shpenzime të tjera të deklaruara nga subjekti, të cilat nuk janë përfshirë në çmimin e kontratës.

Nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës *Vetting* për periudhën e hetimit, pra 2003 – 2016 të kryer nga Komisioni rezultoi fillimisht se: subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë në shumën totale prej 6,984,669 lekësh.

Komisioni, në lidhje me analizën financiare, ka konstatuar se:

- Subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij, znj. L.B., për periudhën 2003 – 2016 rezultojnë me një balancë negative në shumën 6,984,669 lekë si të ardhura të pamjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë.

Për konstatimin e mësipërm subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin D të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet e datës 27.7.2020, ka shpjeguar se:

- Lidhur me konstatimin e Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme në analizën financiare të vitit 2003 në shumën -3,319, 070 lekë, në analizën financiare duhet të reflektohet çdo e ardhur e tij dhe e nënës qëkur kanë filluar punë për herë të parë e deri ditën e deklarimit fillestar, si dhe çdo e ardhur tjetër deri në këtë deklaratë.

Së pari, analiza financiare për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurive, duke qenë se bëhet fjalë për deklaratën e parë para fillimit të detyrës, nuk mund të bëhet me të ardhurat nga data 1.1.2003 deri më 31.12.2003. Pavarësisht se në analizën financiare Komisioni shprehet se ka marrë në analizë të ardhurat e pensioneve që nga viti 1981 për nënën e subjektit, në tabelën e vitit 2003 janë cituar të ardhurat vetëm për vitin 2003.

Së dyti, subjekti deklaron se nuk janë llogaritur të ardhurat nga puna e tij nga viti 1974 për të cilat ka depozituar dokumentacion provues në deklaratën *Vetting*.

Së treti, subjekti arsyeton se diferenca prej -3,319, 070 lekësh bie vetëm duke marrë për bazë një shitje pasurie përpara vitit 2003 të bërë prej tij dhe nëna e tij në shumën 3,600,000 lekë. Në cilësinë e provës, subjekti ka depozituar kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2001, kontratë e cila është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

Së katërti, para vitit 2003, nga personi i lidhur me subjektin janë kryer shitje pasurish të paluajtshme, për të cilat subjekti ka vënë në dispozicion : (i) kontratë shitje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.1999; (ii) kontratë shitjeje me nr. 415 rep., nr. 44 kol., datë 7.3.2000; (iii) kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2004. Këto kontrata janë dorëzuar me deklaratën *Vetting*.

⁷⁴ Fatura e blerjes së automjetit tip “Benz 170” viti 2000, me targa ***, e datës 21.1.2005 me vlerë 6,000 euro; fatura e blerjes së automjetit tip “Benz B180” viti 2011, me targa ***, e datës 30.8.2013 me vlerë 14,500 euro.

⁷⁵ Deklarata doganore e datës 25.1.2005 sipas së cilës është paguar shuma prej 384,211 lekësh detyrime doganore për zhdoganimin e automjetit me targa ***, deklaratë doganore ***, e datës 12.9.2013 sipas së cilës është paguar shuma prej 413,973 lekësh detyrime doganore për zhdoganimin e automjetit me targa ***.

Së pesti, prindërit e subjektit të rivlerësimit vetëm nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për përlogaritjen e pensionit kanë përfituar shumat 881,801 lekë, datë 3.10.1996 (babai i subjektit) dhe 717,956 lekë, datë 11.11.1997 (nëna e subjektit).

Me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtoria e Pagesave të Dëmshpërblimeve, rezulton se babai i subjektit ka marrë shumën 200,000 lekë dhe 2,934,136 lekë letra me vlerë.

Subjekti deklaron se me të ardhurat e tij të ligjshme, babai i tij ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurisë së tij, që më pas ia ka trashëguar subjektit të rivlerësimit në shumën 10,000 USD dhe që ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës 10,000 USD në “Intesa Sanpaolo Bank”.

- Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në analizën financiare për vitin 2007 në shumën -1,669,889 lekë, gjatë kësaj kohe ka gjetur dokumentacion ligjor për shitjen e banesës në Golem (trashëguar nga shtetasi B.B.), nga ku nëna e subjektit është trashëgimtare me 1/5 pjesë në shumën 37,000 euro ($37,000 \times 1/5 = 7400 \text{ euro} \times 125.19 = 926,406 \text{ lekë}$). Gjithashtu, subjekti ka depozituar kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2007 e lidhur midis shtetasve L., F., P., A., S., S., L., dhe D.B., dhe shtetasit F.M., me çmimin 1,900,000 lekë për një apartament në “Rrugën e ***”, të trashëguar nga shitësit si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit B.B. Nga kjo marrëveshje nëna e subjektit ka përfituar shumën rreth 380,000 lekë.
- Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në analizën financiare për vitin 2008, në shumën – 909,359 lekë, referuar DPV-së së vitit 2008 në zërin e pasurive është shtuar vetëm depozita në “Raiffeisen Bank” në shumën 5,000 euro dhe si burim ka shërbyer qiraja e marrë në shumën 600,000 lekë, e cila është deklaruar po në këtë deklaratë në zërin e të ardhurave.
- Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në analizën financiare për vitin 2013 në shumën – 555,556 lekë, duke qenë se për blerjen e automjetit tip “Benz 180 B Class” është përdorur depozita në “Raiffeisen Bank” që është mbyllur në janar të vitit 2014, nga zëri i shpenzimeve në vitin 2013 duhet zbritur shuma 10,000 euro.
- Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme në analizën financiare për vitin 2016, në shumën - 304,132 lekë, ka rezultuar se edhe pse nëna e tij që prej periudhës 2005 – 2016 nuk ka qenë subjekt deklarimi, i është konsideruar se shuma e deklaruar *cash* është një shumë që është krijuar vetëm në vitin 2016, duke i injoruar të ardhurat ndër vite edhe pse në f. *** të deklaratës *Vetting*, lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 1,400,000 lekësh ka theksuar si “të ardhura nga shitja e pronave, kursime.”

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjyqësor

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e ligjshëm të depozitës së krijuar nga nëna e tij në shumën 28,659.62 USD, në vitin 2003, nga e cila më pas në vitet në vazhdim janë gjeneruar depozita të tjera.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimin e krijimit të depozitës së krijuar nga nëna e tij në shumën 28,659.62 USD në vitin 2003, ka deklaruar se nuk është krijuar me të ardhurat e vitit 2003, pavarësisht se është hapur si depozitë në vitin 2003. Subjekti ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e krijuara ndër vite nga nëna e tij, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës.

Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit: kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2001, si provë që subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë përfituar shumë 3,600,000 lekë të ardhura nga shitja e shtëpisë së përfituar falas nga shteti me statusin e invalidit të luftës; kontratë shitjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.4.1999 si provë që nëna e tij ka përfituar nga pjesa e saj takuese 1/5 e çmimit të shitjes prej 200,000 lekësh nga kontrata e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2000 si provë që nëna e tij ka përfituar nga pjesa e saj takuese 1/5 e çmimit të shitjes prej 250,000 lekësh; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2004 si provë që nëna e tij ka përfituar nga pjesa e saj takuese 1/5 e çmimit të shitjes prej 1,147,500 lekësh.

Komisioni vëren se në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të marrë në analizë të ardhurat nga puna e tij duke nisur nga viti 1974 nuk qëndron, pasi Komisioni i ka llogaritur këto të ardhura si të shpenzuara në periudhat përkatëse, duke qenë se subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003 nuk ka deklaruar kursime.

Komisioni vëren se në lidhje me shumë 10,000 USD si trashëgimi nga babai, subjekti faktoi krijimin e kësaj shume me burime të ligjshme financiare nga të ardhura të përfituara ndër vite nga trashëgimlënësi.

Subjekti ka depozituar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga babai i tij, konkretisht si provë edhe shkresën nr. ***, datë 15.7.2020, të ISSh-së (Drejtoria Rajonale Tiranë), ku konfirmon se është zbatuar vendimi nr. ***, datë 26.6.1996, i Gjykatës së Kasacionit Tiranë për z. M.Ç., i cili ka përfituar shumë prej 881,801 lekësh më 3.10.1996.

Gjithashtu, bazuar te shkresa nr. *** prot., datë 17.7.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, Drejtoria e Pagesave të Dëmshtëpërblimeve rezulton se babai i subjektit është rimbursuar si i përndjekur politik me shumë 200,000 lekë dhe 2,934,136 lekë letra me vlerë, pasqyruar kjo në VKM-në nr. 1147, datë 25.11.2009. Babai i tij i ka administruar personalisht të ardhurat e tij.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare për vitin 2007, ka depozituar dokumentacion ligjor për shitjen e banesës në Golem (trashëguar nga z. B.B.), nga ku nëna e subjektit është trashëgimtare me 1/5 pjesë në shumë 37,000 euro ($37,000 \times 1/5 = 7,400$ euro $\times 125.19 = 926,406$ lekë).

Referuar kërkesës ligjore për të ardhura të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar pagesën e tatimit për shumë e përfituar nga nëna e tij dhe trashëgimtarët e tjerë të kësaj prone, pasi transferimi i saj është bërë me kontratë sipërmarrjeje.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2007, e lidhur midis shtetasve L.B., etj., dhe shtetasit F.M., me çmimin 1,900,000 lekë për një apartament në Rrugën e ***, të trashëguar nga shitësit si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit B.B. Nga kjo marrëveshje, nëna e subjektit, me pjesë takuese 3/15, ka përfituar shumë rreth 380,000 lekë.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare për vitin 2008, ka shpjeguar burimin e ligjshëm të depozitës së krijuar në vitin 2008, por nuk ka argumentuar mungesën e burimeve të ligjshme për këtë vit.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare për vitin 2013, ka shpjeguar se për blerjen e automjetit tip “Benz 180 B Class” është përdorur depozita në “Raiffeisen Bank” që është mbyllur në janar të vitit 2014. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se automjeti tip “Benz 180 B Class”, blerë në vitin 2013, paguar një pjesë në vitin 2013 dhe një pjesë në janar të vitit 2014.

Lidhur me shpjegimin se automjetin tip “Benz 180 B Class”, të blerë në vitin 2013 nuk e ka paguar plotësisht në këtë vit, subjekti i rivlerësimit e ka dhënë edhe në deklaratën periodike të vitit 2013.

Komisioni ka konfirmuar se nga lëvizjet bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” në janar të vitit 2014 janë bërë dy tërheqje përkatësisht në datën 6.1.2014, në shumën 3,500 euro dhe në datën 7.1.2014, në shumën 6,650 euro.

Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, lidhur me analizën financiare për vitin 2016, ka argumentuar diferencën negative si rezultat i llogaritjes së kursimeve *cash* të deklaruara nga nëna e tij në deklaratën *Vetting* në shumën 1,400,000 lekë, si kursime të krijuara vetëm në vitin 2016, ndërkohë që këto kursime janë kursimet e gjithë jetës së saj të krijuara ndër vite. Shpërndarja e kursimeve të nënës është shtrirë në periudhën 2003 – 2016, në progresion rritës me të njëjtën prirje që kanë ndjekur të ardhurat nga pensioni, periudhë kohore në të cilën nuk konstatohen deklarime nga nëna e subjektit.

Komisioni, lidhur me depozitat në monedhë të huaj të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, nënën e tij, ka saktësuar në analizën financiare kundërvleftën e tyre në monedhën lekë në fund të çdo viti, duke kryer vlerësimin e shtesës së këtyre depozitave me kursin e këmbimit të vitit përkatës, kur është krijuar shtesa e depozitës.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për analizën financiare të periudhës 2003 – 2016, ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse, si dhe ka depozituar dokumentacion për burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës 28.659,62 USD të krijuar nga nëna e subjektit në vitin 2003, si dhe për të ardhurat e trashëguara nga babai i tij me të cilat subjekti i rivlerësimit ka krijuar depozitën prej 10,000 USD në vitin 2003. Komisioni ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit në analizën e rishikuar duke shtuar në analizën financiare edhe të ardhurat nga interesat e krijuara nga këto depozita. Subjekti i rivlerësimit ka provuar me dokumentacion të ardhurat e përfituara nga nëna e tij në vitin 2007, nga kontratat e shitjes së pasurive të trashëguara nga i ndjeri vëllai i saj, B.B. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion pagesën e tatimit për të ardhurën nga shitja e vilës në Golem në shumën 37,000 euro dhe për këtë arsye vlera e marrë në konsideratë në analizën e rishikuar është në shumën 29,000 USD. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me mungesën e burimeve në analizën e viteve 2013 dhe 2016. Komisioni ka marrë në konsideratë në analizën e rishikuar pagesën e kryer në janar të vitit 2014 me depozitën e tërhequr në “Raiffeisen Bank” për automjetin tip “Benz 180 B Class”, të blerë në vitin 2013. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe të plota në lidhje me kursimet *cash* në shumën 1,400,000 lekë të nënës së tij të deklaruara në deklaratën *Vetting*. Komisioni mori në konsideratë shpjegimin e tij duke e konsideruar shumën prej 1,400,000 lekësh si kursime të akumuluar nga nëna e subjektit ndër vite.

Në përfundim të analizës financiare të rishikuar rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë në shumën totale prej 763,778 lekësh.

Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat	2,156,791	3,362,683	1,687,714	2,011,166	3,269,824	2,584,276	2,558,147	3,501,545	3,401,751	3,876,283	4,574,212	3,596,445	3,282,474	3,261,355
Të ardhura nga paga	637,099	799,919	813,230	856,226	1,152,829	886,577	957,881	974,871	985,739	1,012,962	1,320,221	1,261,069	1,261,193	1,273,316
Të ardhura nga përcjimi	437,891	474,301	501,769	568,633	602,997	650,733	707,068	735,716	765,621	803,307	835,802	857,116	872,402	887,528
Të ardhura nga qiraja e banesës***, Ap.***	0	0	243,000	540,000	561,600	518,400	612,086	961,953	1,045,548	1,056,283	1,059,988	1,059,232	870,499	855,447
Të ardhura nga interesat	0	2,081	129,214	46,307	90,824	308,567	281,113	303,965	416,502	422,331	445,021	419,028	231,831	143,064
Të ardhura nga paga si lektor	0	0	0	0	0	0	0	23,040	36,000	36,000	0	0	46,550	0
Të ardhura nga honoraret KLD	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	102,000
Të ardhura nga dëmtshpërblimi i babait si i burgosur politik	0	0	0	0	0	0	0	251,000	0	0	250,000	0	0	0
Të ardhura nga dëmtshpërblimi i bashkëshortit si i burgosur politik	0	0	0	0	0	0	0	251,000	0	0	250,000	0	0	0
Të ardhura nga trashëgimia 10,000 USD (deklaruar DPV 2003)	1,081,801	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L. B (14. Shije t'ruallit shtetas A. B me kontratën nr.*** rep. nr.*** kol. datë 23.01.2008 në shumën 600,000 lekë 1/6-3/15 e 1/6.)	0	0	0	0	0	120,000	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (15. Shije t'ruallit shtetas H.A me kontratën nr.*** rep. nr.*** kol. datë 23.01.2008 në shumën 500,000 lekë 1/6-3/15 e 1/6.)	0	0	0	0	0	100,000	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (16. Shije t'ruallit shtetas S.J me kontratën nr.**** rep. nr.*** kol. datë 17.12.2012 në shumën 2,727,000 lekë 1/6-3/15 e 1/6.)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	545,400	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (17. Shije në banesë në ***. Durrës e vëllait trashëgimtarës B.B e 1/5 e vlerës)	0	0	0	0	481,574	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (18. Shije apartament banimi në Tiranë e vëllait trashëgimtarës B.B e 1/5 e vlerës)	0	0	0	0	380,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e aksioneve *****	0	1,461,518	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga dëmtshpërblimi për ish të dëmtuarin L.B	0	0	0	0	0	0	0	0	152,340	0	152,340	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (-Kontrata e shijes e datës 20.09.2004 me shtetë 5 bashkëpronarët B. + L.B) dhe blerës EKB Fier për pasurinë t'ruall me sipërfaqe totale 88.7m2 + ndërtësi me sip.70m2 me çmimin 1,454,187 lekë)	0	242,365	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (-Kontrata e shijes e datës 20.09.2004 me shtetë 5 bashkëpronarët B. + L.B) dhe blerës EKB Fier për pasurinë t'ruall me sipërfaqe totale 74.8m2 + ndërtësi me sip.57.2m2 me çmimin 1,147,500 lekë)	0	191,250	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e pasurive L.B (-Kontrata e shijes e datës 20.09.2004 me shtetë 5 bashkëpronarët B. + L.B) dhe blerës EKB Fier për pasurinë t'ruall me sipërfaqe totale 68.5m2 + ndërtësi me sip.58.8m2 me çmimin 1,147,500 lekë)	0	191,250	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shija e mjetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	560,840	0	0	0
Detyrime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzime	187,728	282,783	352,070	473,942	599,697	590,429	609,307	777,084	721,332	715,180	625,563	868,733	790,250	754,251
Shpenzime jetike	187,728	187,728	219,114	219,114	273,240	273,240	273,240	273,240	273,240	282,048	282,048	439,996	448,552	470,184
Shpenzime udhëtimi	0	95,055	132,956	254,828	326,457	317,189	336,067	503,844	448,092	433,132	343,515	428,737	181,698	284,067
Shpenzime mobilimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shpenzime mjekësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	160,000	0
Pasuri	-3,121,418	1,910,259	298,629	738,467	3,195,082	2,232,671	1,056,819	2,275,923	1,495,214	1,842,112	3,115,008	1,943,273	1,292,641	1,424,319
Kursime (Shtim/pakësimi likuiditetesh cash + bankë)	-3,121,418	1,910,259	-807,295	738,467	3,195,082	2,232,671	1,056,819	2,275,923	1,495,214	1,842,112	1,923,853	542,173	1,292,641	1,424,319
Apartament banimi 2+1. 122 m2 Rr.***, Tiranë														
Aksione ***** sha	0	0	1,105,924	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Autoveturë tip Benz 170 vit 2000, targa ****	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,191,155	1,401,100	0	0
Autoveturë tip Benz B180 vit 2011, targa ****	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Apartament banimi 2+1,kati*, 91.2 m2 blv. ****nr.****														
Të ardhura + detyrime - shpenzime - pasuri	5,090,481	1,169,641	1,037,015	798,756	-524,955	-238,823	892,021	448,538	1,185,205	1,318,990	833,641	784,439	1,199,583	1,082,784

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision, me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2020, raportin mbi kontrollin e figurës me nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, i deklasifikuar plotësisht dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

“Për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo, administrohen informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

*Konkretisht, ***** në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Petrit M. Çomo disponohen të dhëna ***** nga të cilat ngrihen dyshime për favorizim të personave në gjykim dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm.*

*Petrit M. Çomo ***** ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe ngrihen dyshime se një person tjetër ka ushtruar ndikim të paligjshëm ndaj gjyqtarit Petrit Çomo, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për disa çështje gjyqësore.*

Për sa më sipër:

- a) Bazuar në informacionin ***** mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit Petrit M. Çomo në veprimtari të paligjshme janë informuar edhe strukturat ligjzbatuese.*
- b) Informacioni që disponohet për implikim të subjektit të rivlerësimit Petrit Çomo në favorizim të personave të ndryshëm dhe ushtrim të ndikimit të paligjshëm lidhet drejtpërdrejt me detyrën e tij funksionale, çfarë e bën subjektin në fjalë person me tendencë për përfshirje në veprimtari kriminale dhe një individ që mund të vihet nën presion nga struktura kriminale, vlerësim i mbështetur në gerrat “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.*
- c) Informacioni në ngarkim të subjektit të rivlerësimit evidenton qartë se ***** ka pasur kontakte të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar, e padeklaruar nga ky subjekt në deklaratën e kontrollit të figurës, pjesa 5 (të dhëna për sigurinë), gerrat “c” dhe “ç”, parashikuar edhe në nenin 38, pika nr. 6, germa “b” e ligjit 84/2016.*
- d) Mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit e kontakteve të papërshtatshme me një person të përfshirë në krimin e organizuar e ngarkon subjektin e rivlerësimit Petrit Çomo me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti, e plotësisht të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës.”*

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer hetime të thelluara në lidhje me konstatimet e raportit të DSIK-së, si vijon:

- Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁷⁶ konfirmon se nga verifikimi nuk rezulton që nga kjo gjykatë të jenë dhënë vendime ndaj shtetasit ***, si dhe nuk ka çështje aktualisht në gjykim në ngarkim të tij.

⁷⁶ Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nr. *** prot., datë 12.5.2020.

- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁷⁷ konfirmon se pas verifikimit të veprave penale të kësaj prokurorie nuk rezulton që në ngarkim të shtetasit *** të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
- Komisioni ka kryer korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme, ku i ka kërkuar informacion për procedime penale, kallëzime apo kërkesa për gjykim në lidhje me shtetasin ***.
- Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional⁷⁸, ka përcjellë pranë Komisionit informacionin e vënë në dispozicion nga drejtoritë e Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve.
- Prokuroritë e rretheve gjyqësore⁷⁹ konfirmojnë se ndaj shtetasit *** nuk rezulton se ka kallëzime apo te jenë regjistruar procedime penale në ngarkim të tij.
- Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁸⁰ konfirmon se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetasit ***.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier⁸¹ konfirmon se ka regjistruar procedimin penal nr. **, datë 9.3.2017, në ngarkim të shtetasit *** për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”.

Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime të detajuara, shoqëruar me prova shkresore, në lidhje me çdo konstatim në raportin e DSIK-së.

Qëndrimi i subjektit

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, ka shpjeguar nuk është dakord me raportin mbi kontrollin e figurës nr. ** prot., datë 2.11.2017, dërguar nga DSIK-ja, duke i konsideruar konkluzionet e paraqitura si krejtësisht subjektive dhe të pabazuara në asnjë provë. Nga hetimet e kryera nga Komisioni ka rezultuar se asnjëri nga personat të cilët përmenden në raportin e DSIK-së si të papërshtatshëm, pasi sipas tyre janë përfshirë në krimin e organizuar, nuk kanë qenë subjekte të krimit të organizuar. Në dosje nuk gjendet asnjë provë ku të bazohen konstatimet subjektive të raportit të DSIK-së.

Subjekti ka shpjeguar se edhe në pyetësorët e mëparshëm (nr. 4) ka sqaruar njohjen me shtetasin A. B. Ky person nuk ka qenë kurrë subjekt i krimit të organizuar dhe me dijeninë e subjektit nuk

⁷⁷ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nr. ** prot., datë 15.5.2020.

⁷⁸ Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional nr. ** prot., datë 29.5.2020.

⁷⁹ Prokuroritë e rretheve gjyqësore: Tropojë, me nr. ** prot., datë 12.5.2020; Kurbin, me nr. ** prot., datë 11.5.2020; Dibër, me nr. ** prot., datë 13.5.2020; Përmet, me nr. ** prot., datë 12.5.2020; Pukë, me nr. ** prot., datë 13.5.2020; Shkodër, me nr. ** prot., datë 12.5.2020; Berat, me nr. ** prot., datë 13.5.2020; Lushnje, me nr. ** prot., datë 16.5.2020; Krujë, me nr. ** prot., datë 18.5.2020; Vlorë, me nr. ** prot., datë 21.5.2020; Kavajë, me nr. ** prot., datë 21.5.2020; Korçë, me nr. ** prot., datë 20.5.2020; Tiranë, me nr. ** prot., datë 26.5.2020; nr. ** prot., datë 26.6.2020; Gjirokastrë, me nr. ** prot., datë 20.5.2020; Kukës, me nr. ** prot., datë 18.5.2020; Lezhë, me nr. ** prot., datë 19.5.2020; Elbasan, me nr. ** prot., datë 20.5.2020; Durrës, me nr. ** prot., datë 20.5.2020; Pogradec, me nr. ** prot., datë 29.5.2020; Sarandë, me nr. ** prot., datë 29.5.2020; Mat, me nr. ** prot., datë 27.5.2020.

⁸⁰ PPKKKO me nr. ** prot., datë 15.5.2020.

⁸¹ Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me nr. ** prot., datë 13.5.2020.

ka qenë i dënuar as për ndonjë veprë penale të zakonshme, ndërsa shtetasin T. M. nuk kujton ta ketë takuar ndonjëherë.

Gjithashtu, nga dokumentet të cilat janë shqyrtuar gjatë hetimit nga Komisioni, nuk rezultojnë asnjë shkelje e bërë prej subjektit në lidhje me figurën e gjyqtarit. Nuk ka asnjë provë (në dijeninë e tij) që të ketë pasur ndonjë ankesë, informacion apo vlerësim negativ për subjektin nga ndonjë institucion gjatë punës së tij mbi 20 vjeçare. Subjekti deklaroi, ndër të tjera, se edhe ankesat ndaj tij nga shtetas të ndryshëm kanë qenë shumë të pakta. Për këto arsye subjekti deklaroi se konkluzioni i arritur nga DSIK-ja është jo i drejtë dhe tej kompetencave të përcaktuara nga ligji.

Subjekti ka shpjeguar se edhe pse ka gjykuar persona të akuzuar, dhe më pas të dënuar për vepra penale shumë të rënda të krimit të organizuar, asnjëherë nuk është ndikuar nga ndërhyrje apo presione në këto gjykime. Siç është përmendur edhe më lart nga subjekti dhe siç rezultojnë edhe nga hetimet, rezultoi se ai nuk ka pasur kontakt me asnjë person të lidhur me krimin e organizuar dhe se nuk ka ndonjë provë për të paraqitur lidhur me këtë fakt. Në të gjitha vendimet që ka dhënë gjatë këtyre viteve subjekti shpjegon se është bazuar në ligj, në prova dhe në bindjen e brendshme dhe se asnjëherë nuk ka dhënë ndonjë vendim për shkak presionesh apo ndikimesh të çfarëdollojshme.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vëren se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së referojnë në dyshime për veprime të paligjshme, me natyrë korruptive dhe ndikim të paligjshëm në disa çështje gjyqësore, si dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni, në lidhje me informacionin e referuar, ka kryer hetime të thelluara dhe të plota të pasqyruara si më lart, dhe nuk u arrit në përfundimin që këto të dhëna të referuara në raportin e DSIK-së të provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).

Gjithashtu, Komisioni mori në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe i konsideroi bindëse dhe të plota.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni:

- a) Nuk u provua favorizimi i personave të ndryshëm në procese gjyqësore, për arsye se nga korrespondencat e kryera me organet ligjzbatuese nuk u provua pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit qoftë si gjyqtar i vetëm, apo edhe si anëtar trupe gjyqësore, në procese gjyqësore ku kanë qenë palë subjektet e përmendura në raport.
- b) Nuk u provua ushtrimi i ndikimit të paligjshëm që lidhet drejtpërdrejt me detyrën funksionale të subjektit tek subjekte të tjera rivlerësimi, gjyqtarë apo prokurorë. Edhe në një rast të konstatuar në raport nuk vërtetohet, qoftë nga organet ligjzbatuese, ashtu edhe nga hetimi i Komisionit, lidhja shkak-pasojë, nuk vërtetohet lidhja konkluzive ndërmjet marrjes përsipër për dhënien e ndihmës, kontaktimit të ndonjë subjekti rivlerësimi, gjyqtar, kërkimit për të favorizuar një palë ndërgjyqësore, si dhe dhënia e një vendimi gjyqësor në favor të palës ndërgjyqësore si rezultat i ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nga subjekti i rivlerësimit.

Përderisa nga hetimi nuk rezultoi e provuar lidhja shkak-pasojë, e argumentuar si më sipër, është e pamundur t'i atribuohet subjektit të rivlerësimit vepra e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

Vlen të theksojmë se shtetasi që supozohet se është favorizuar është shpallur i pafajshëm me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Dyshimet për kryerjen e ndonjë veprimi në të ardhmen, nuk u provuan dhe as janë pasuar me indicje të tjera, qoftë edhe në formë tentativash të subjektit, rrethana këto që nuk mund të vlerësohen deri në atë masë që mund të çenojnë besimin e publikut. Në këtë drejtim trupi gjykues vlerëson se edhe shpjegimet e subjektit i gjen objektivisht bindëse e për rrjedhojë çmon se nuk ka rrethana të provuara që mund ta ngarkojnë atë me ndonjë përgjegjësi brenda përcaktimeve të nenit 61/5 të ligjit nr.84/2016.

- c) Nuk u provua ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme dhe mosdeklarimi i tyre në deklaratën e kontrollit të figurës.

Nga i gjithë hetimi i thelluar i kryer nga Komisioni, përfshirë edhe korrespondencën me organet ligjzbatuese, nuk rezultoi që subjektet e përmendura në raport të ishin të përfshirë në krimin e organizuar dhe, për rrjedhojë, që subjekti i rivlerësimit të kishte kontakte të papërshtatshme me ta.

Nuk rezultoi që për këto subjekte të ishin marrë vendime apo të ishin regjistruar si të proceduar për vepra penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar.

Konkluzion

Komisioni vëren se nga hetimet e kryera nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të jetë përfshirë në veprime korruptive apo të ketë kryer veprime me qëllim ushtrimin e ndikimit të paligjshëm në çështje gjyqësore. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Grupi i punës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin me nr. *** prot., datë 19.4.2019, për të analizuar aftësitë profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çomo.

Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit, nga ku subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi të mira në drejtim të:

- ✓ aftësive profesionale, ku përfshihen: a) njohuritë ligjore; dhe b) arsyetimi ligjor;
- ✓ aftësive organizative, ku përfshihen: a) aftësia për të përballuar ngarkesën në punë; b) aftësia për të kryer procedurat gjyqësore; dhe c) aftësia për të administruar dosjet;
- ✓ etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, ku përfshihen: a) etika në punë; b) integriteti; dhe c) paanësia.
- ✓ aftësive personale dhe angazhimit profesional, ku përfshihen: a) aftësitë e komunikimit; b) aftësia për të bashkëpunuar; dhe c) gatishmëria për t’u angazhuar.

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, është vlerësuar “shumë mirë”, me vendimin nr. ***, datë 11.10.2013, të KLD-së, për periudhën 2005 – 2006, dhe me vendim nr. ***, datë 4.11.2016, të KLD-së, për periudhën 2007 – 2009.

❖ 3 (tri) dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Në lidhje me tri⁸² dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nga Grupi i punës pranë KLGJ-së, si dhe nga rivlerësimi i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit.

❖ 5 (pesë) dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short

Në lidhje me pesë⁸³ dosjet e përzgjedhura me short, nga Grupi i punës pranë KLGJ-së, si dhe nga procesi i rivlerësimit i kryer nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit.

❖ Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Petrit Çomo janë paraqitur 4 ankesa (1 në vitin 2013, 2 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2015), në Inspektoratin e KLD-së. Katër ankesat janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

⁸² Dokumenti 1 - Vendimi nr. ***, datë 9.12.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit O. K., akuzuar për veprat penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë, “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake, falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave dhe falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga nenet 79/ë-22, 278/2, 189/1 dhe 186/1 të Kodit Penal.

Dokumenti 2 - Vendimi nr. ***, datë 1.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit E. B., akuzuar për veprat penale “vrasje me dashje dhe mbajtje pa leje të armëve të ftohta”, parashikuar nga nenet 76 dhe 279/2 të Kodit Penal.

Dokumenti 3 - Vendimi nr. ***, datë 20.3.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit P.R., i akuzuar për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

⁸³ Dosja 1 - Çështja penale nr. *** regjistri, datë 8.10.2013, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurve B. P. dhe R. Sh., akuzuar për kryerjen e veprës penale “shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga nenet 290/2 dhe 291 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 25.11.2013.

Dosja 2 - Çështja penale nr. *** regjistri, datë 11.7.2013, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit M. S., akuzuar për kryerjen e veprave të turpshme me të mitur, parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 17.12.2013.

Dosja 3 - Çështja penale nr. *** regjistri, datë 29.7.2014, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit Xh. B., akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje, mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 134/1 dhe 22 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 5.11.2014.

Dosja 4 - Çështja penale nr. *** regjistri, datë 9.10.2015, që i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kundër të pandehurit I. A., akuzuar për kryerjen e veprës penale “drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 9.11.2015.

Dosja 5 - Çështja penale nr. *** regjistri, datë 7.5.2015, që i përket të dëmtuarit akuzues P.R., kundër të akuzuarës S.K., akuzuar për kundërvajtjen penale “shpifje në dëm të disa personave”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 12.6.2015.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Petrit Çomo përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë ankesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

❖ Të dhëna nga prokuroritë

Prokuroria e Përgjithshme, Sektori i Protokollit dhe Arkivit⁸⁴, konfirmon se nuk rezultojn që ndaj subjektit Petrit M. Çomo të ketë çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj tij. Po kështu, për periudhën 2006 – 2019 nuk rezultojn të ketë ankesa ndaj këtij subjekti.

Prokuroria e Përgjithshme, Sekretaria Sekrete⁸⁵, konfirmon se ndaj subjektit Petrit Çomo nuk ka ndonjë të dhënë apo *indicie* të ardhur nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve ndaj tij.

Prokuroritë e rretheve gjyqësore⁸⁶ kanë konfirmuar se ndaj subjektit Petrit Çomo nuk rezultojn të jenë bërë kallëzime apo të kenë filluar procedime penale pranë këtyre prokurorive.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁸⁷ konfirmon se ndaj subjektit Petrit Çomo dhe 18 subjekteve të tjera (gjyqtarë dhe prokurorë) është bërë një kallëzim penal nga shtetasja L. P., që u referohet për dhënie vendim të padrejtë dhe pas verifikimeve nga kjo prokurori është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

KONSTATIME TË TJERA

Komisioni, nisur nga disa *indicie* të tjera, për sa i përket aspektit profesional, ka vlerësuar të arsyeshme të kryejë hetime të mëtejshme për verifikimin e disa çështjeve civile/penale me palë, shoqërinë “****” sh.p.k, A.B., dhe T.M. Për këtë qëllim Komisioni ka kryer korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë⁸⁸ konfirmon se nga verifikimi në sistem i subjekteve të sipërcituar, për shtetasin T.M., nuk rezultojn të ketë pasur çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate për vitin 2014. Edhe në një çështje gjyqësore që ka rezultuar nga kërkimi në vitin 2015, por që nuk është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, por nga gjyqtari A.A., ky person është shpallur i pafajshëm me vendimin nr. ***, datë 10.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “refuzim për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i remë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin

⁸⁴ Prokuroria e Përgjithshme, nr. *** prot., datë 7.10.2019.

⁸⁵ Prokuroria e Përgjithshme, nr. *** prot., datë 30.10.2019.

⁸⁶ Prokuroritë e rretheve: Krujë, me nr. *** prot., datë 11.11.2019; Lezhë, me nr. *** prot., datë 2.10.2019; Shkodër, me nr. *** prot., 4.10.2019; Sarandë, me nr. *** prot., datë 26.9.2019; Korçë, me nr. *** prot., datë 26.9.2019; Elbasan, me nr. *** prot., datë 27.9.2019; Pogradec, me nr. *** prot., datë 26.9.2019; Gjirokastrë, me nr. *** prot., datë 25.9.2019; Përmet, me nr. *** prot., datë 20.9.2019; Lushnjë, me nr. *** prot., datë 23.9.2019; Tropojë, me nr. *** prot., datë 23.9.2019; Berat, me nr. *** prot., datë 23.9.2019; Kavajë, me nr. *** prot., datë 20.9.2019; Durrës, me nr. *** prot., datë 25.9.2019; Mat, me nr. *** prot., datë 20.9.2019; Kukës, me nr. *** prot., datë 25.9.2019; Pukë, me nr. *** prot., datë 20.9.2019; Kurbin, me nr. *** prot., datë 23.9.2019; Dibër, me nr. *** prot., datë 24.9.2019; Vlorë, me nr. *** prot., datë 26.9.2019; Fier, me nr. *** prot., datë 27.9.2019; Tiranë, me nr. *** prot., datë 2.10.2019.

⁸⁷ Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me nr. *** prot., datë 2.10.2019.

⁸⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. *** prot., datë 18.3.2020.

ligjor për deklaram”, vendim që është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.5.2016, me trupë gjykuese Sh.M., A.B., dhe F.Q. Ndërsa për shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shtetasin A.B., gjykata ka vënë në dispozicion të Komisionit 18 vendime gjyqësore civile.

Nga verifikimi i këtyre vendimeve rezulton se subjekti Petrit Çomo nuk ka qenë gjyqtari që ka gjykuar apo që të ketë qenë pjesë e trupës gjykuese të tyre. Në vendimet gjyqësore, si palë në gjykim në 17 vendime, ka qenë shoqëria “****” sh.p.k., ndërsa shtetasi A.B., ka qenë palë vetëm në një vendim.

Katër vendime gjyqësore që shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur me subjekte të ndryshme kanë përfunduar me pranim padie në favor të kësaj shoqërie⁸⁹. Tetë vendime të tjera që kjo shoqëri ka pasur me subjekte të ndryshme, ku dy prej tyre kanë qenë me palë Drejtorinë Rajonale Tatimore, kanë përfunduar me pushim gjykimi apo/dhe kthim aktesh⁹⁰. Tri vendime të tjera ku kjo shoqëri ka pasur si palë subjekte të ndryshme, ku në dy prej tyre ka qenë palë Drejtoria Rajonale Tatimore/Tatimpaguesit e mëdhenj kanë përfunduar me shpallje moskompetence⁹¹. Dy vendime gjyqësore që shoqëria “****” sh.p.k., ka pasur si palë subjekte të ndryshme, gjykata ka vendosur

⁸⁹ Vendimi nr. ***, datë 29.6.2006, gjykuar nga gjyqtari M. B., me paditës shoqëria “****” sh.p.k., me administrator dhe i paditur Policia Elektrike, me objekt “shfuqizim akti administrativ dhe pezullim” e cila ka përfunduar duke pranuar padinë e shoqërisë “****” sh.p.k.; vendimi nr. ***, datë 29.5.2012, gjykuar nga gjyqtari N. C., me paditës shoqëria “****” sh.p.k., dhe i paditur ZVRPP-ja Tiranë me objekt “anulim bllokim pasurie” e cila ka përfunduar me pranim padie; vendimi nr. ***, datë 3.7.2012, gjykuar nga gjyqtari F. H., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Drejtoria e Policisë Bashkiake me objekt “detyrim shpërbllim dëmi” e përfunduar me pranim të pjesshëm të padisë; vendimi nr. ***, datë 2.5.2012, gjykuar nga gjyqtari J. H., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Bashkia Tiranë, me objekt “anulim akti administrativ” përfunduar me pranim padi.

⁹⁰ Vendimi nr. ***, datë 9.5.2008, gjykuar nga gjyqtari E. S., me paditës shoqëria “****” sh.p.k., dhe i paditur Inspektorati i Punës me objekt “konstatim fakti juridik të kalimit të afatit të ekzekutimit”, e cila ka përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 9.5.2008, gjykuar nga gjyqtari A. V., me paditës shoqëria “****” sh.p.k., dhe i paditur Dega e Tatim Paguesve të Mëdhenj, me objekt “anulim i detyrimeve”, përfunduar me kthim aktesh paditësit; vendimi nr. ***, datë 23.4.2009, gjykuar nga gjyqtari A. G., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Dega e Tatim Paguesve të Mëdhenj, me objekt “anulim i pjesshëm i detyrimeve”, përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 5.10.2011, gjykuar nga gjyqtari A. V., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur shërbimi përmbarimor, me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore”, përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 13.2.2012, gjykuar nga gjyqtari F. B., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, me objekt “shfuqizim akti administrativ”, përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 7.2.2011, gjykuar nga gjyqtari E. S., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Drejtoria e Apelimit Tatimor, me objekt “anulim akti administrativ”, përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 9.6.2015, gjykuar nga gjyqtari A. L., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “detyrim pagim shume”, përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 28.5.2015, gjykuar nga gjyqtari J. H. me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “detyrim pagim shume”, përfunduar me pushim gjykimi.

⁹¹ Vendimi nr. ***, datë 5.2.2014, gjykuar nga gjyqtarët A. K., A. G. dhe F. B., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Drejtoria Rajonale Tatimore, me objekt “anulim akti administrativ”, përfunduar me shpallje moskompetence; vendimi nr. ***, datë 30.1.2014, gjykuar nga gjyqtari B. K., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Drejtoria Rajonale Tatimore, me objekt “anulim akti administrativ”, përfunduar me shpallje moskompetence; vendimi nr. ***, datë 1.1.2014, gjykuar nga gjyqtari F. B. me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur Bashkia Tiranë, me objekt “anulim akti administrativ”, përfunduar me shpallje moskompetence.

kundër kësaj shoqërie⁹². Ndërsa, në një vendim shtetasi A.B., ka qenë thirrur si palë person i tretë dhe çështja ka përfunduar me rrëzim padie të paditësit⁹³.

Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, nuk ka gjykuar si gjyqtar i vetëm, si dhe nuk ka qenë pjesë e trupave gjyqësore që kanë gjykuar çështjet gjyqësore të shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve A.B., dhe T.M.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë⁹⁴ konfirmon se nga verifikimi në sistem i subjekteve të sipërcituar, për shtetasit T.M., dhe A.B., nuk rezulton të ketë pasur çështje gjyqësore pranë kësaj gjykate. Ndërsa, për shoqërinë “****” sh.p.k. gjykata ka dërguar 9 vendime gjyqësore administrative për çështje administrative që kjo shoqëri ka pasur pranë saj. Nga verifikimi i këtyre vendimeve rezulton se subjekti Petrit Çomo nuk ka qenë gjyqtari që ka gjykuar apo që të ketë qenë pjesë e trupës gjyqësore të këtyre gjykimeve, pasi kuptohet se ai është gjyqtar i Gjykatës Civile/Penale. Dy vendime gjyqësore (përkatësisht një i vitit 2014 dhe tjetri i vitit 2019), që shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur me subjekte të ndryshme, kanë përfunduar me pranim padie në favor të kësaj shoqërie⁹⁵. Pesë vendime gjyqësore (përkatësisht dy vendime të vitit 2014, 2017, 2018 dhe 2019), që shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur me subjekte të ndryshme, kanë përfunduar me rrëzim padie në disfavor të kësaj shoqërie⁹⁶. Dy vendime gjyqësore (përkatësisht dy vendime të vitit 2019), që shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur me subjekte të ndryshme, kanë përfunduar me pushim gjykimi (me kërkesë të kësaj shoqërie)⁹⁷.

⁹² Vendimi nr. ***, datë 24.11.2016, gjykuar nga gjyqtari E. P., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur shoqëria përmbarimore “****”, me objekt “kundërshtim veprimesh përmbarimore”, përfunduar me rrëzim padie; vendimi nr. ***, datë 5.4.2017, gjykuar nga gjyqtari E. C., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur shoqëria “****” sh.p.k., me objekt “detyrim pagim shume”, përfunduar me pranimin e padisë të paditësit.

⁹³ Vendimi nr. ***, datë 19.11.2014, gjykuar nga gjyqtari M. K., me paditës shoqëria “****” sh.p.k. dhe i paditur “Tirana Bank” dhe person i tretë A.B., etj., me objekt “shuarje e hipotekës, fshirje regjistrimi”, përfunduar me rrëzim padie.

⁹⁴ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me nr. *** prot., datë 17.4.2020 dhe nr. *** prot., datë 24.4.2020.

⁹⁵ Vendimi nr. ***, datë 16.5.2014, i gjykuar nga gjyqtari A. S., me palë paditëse shoqëria “****” sh.p.k., me të paditur Bashkia Tiranë, me objekt “anulimin e aktit administrative nr. ***, datë 17.1.2011”, ka përfunduar me pranimin e padisë të shoqërisë “****” sh.p.k.; vendimi nr. ***, datë 6.8.2019, me palë kërkuese “****” sh.p.k., person i tretë DRT-ja Tiranë, me objekt “marrje e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar gjykatën për pezullimin e zbatimit të masave të bllokimit të aktivitetit”, ka përfunduar me pranimin e kërkesës së shoqërisë “****” sh.p.k.

⁹⁶ Vendimi nr. ***, datë 26.9.2014 i gjykuar nga gjyqtari A. M., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe i paditur DRT-ja Tiranë, me objekt “anulim/shfuqizim i aktit administrativ, njoftim vlerësimi tatimor” dhe ka përfunduar me rrëzimin e padisë së shoqërisë “****” sh.p.k.; vendimi nr. ***, datë 24.10.2014, i gjykuar nga gjyqtari A. S., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k., i paditur DRT-ja Tiranë, me objekt “anulim akti administrative i vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor” ka përfunduar me rrëzimin e padisë së shoqërisë “****” sh.p.k.; vendimi nr. ***, datë 22.9.2017, gjykuar nga gjyqtari G. H., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe i paditur DRT-ja Tiranë, me objekt “anulim akti administrativ”, ka përfunduar me rrëzimin e padisë së shoqërisë “****” sh.p.k.; vendimi nr. ***, datë 26.3.2018, i gjykuar nga gjyqtari G. M., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe i paditur DRT-ja Tiranë, me objekt “shfuqizim akti administrativ”, ka përfunduar me rrëzimin e padisë së shoqërisë “****” sh.p.k.; vendimi nr. ***, datë 16.12.2019, i gjykuar nga gjyqtar A. S., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k. i paditur DRT-ja Tiranë, me objekt “konstatim i pavlefshmërisë absolute i aktit administrativ” dhe ka përfunduar me rrëzimin e padisë së shoqërisë “****” sh.p.k.

⁹⁷ Vendimi nr. ***, datë 2.10.2019, i gjykuar nga gjyqtar E. Ç., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k., i paditur DRT-ja Tiranë, me objekt “shfuqizim i aktit administrativ” dhe ka përfunduar me pushim gjykimi; vendimi nr. ***, datë 7.10.2019, i gjykuar nga gjyqtari G. M., me paditës shoqërinë “****” sh.p.k., person i tretë Bashkia Tiranë, me objekt “sigurim padie” dhe ka përfunduar me pushim gjykimi.

Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, nuk ka gjykuar si gjyqtar i vetëm, si dhe nuk ka qenë pjesë e trupave gjyqësore që kanë gjykuar çështjet gjyqësore të shoqërisë “***” sh.p.k.

DENONCIME NGA PUBLIKU

Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 8 denoncime nga publiku (dy prej denoncuesve i kanë përsëritur dy herë).

- **Denoncimi 1**, datë 2.12.2017, i shtetasit V. Ç., ku ky shtetas është ankuar ndaj subjektit Petrit Çomo për shkak se ky gjyqtar, si anëtar i trupit gjykues, është pajtuar me shkeljet e gjyqtarëve G. H. dhe M. B., duke i dhënë të drejtë një falsifikatori dhe duke ia hequr pronën që ka përfituar me dokumente të rregullta. Ky denoncues nuk ka bashkëngjitur dokumente apo prova, si dhe nuk ka specifikuar shkeljen që pretendon se i është bërë nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni vëren se nuk ka *indicie* apo prova konkrete që ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore.

- **Denoncimi 2**, datë 19.2.2020, sërish i shtetasit V. Ç., ku denoncuesi deklaron se në vjedhjen e banesës së tij tek “Rruga ***” janë përfshirë në korrupsion rreth 40 gjyqtarë dhe prokurorë Tiranë-Durrës dhe anasjelltas ku është i përfshirë edhe kryetari Petrit Çomo. Denoncuesi ka bashkëngjitur edhe disa dokumente.

Komisioni vëren se denoncimi i bërë nga shtetasi V. Ç. është i natyrës administrative. Në ankesën e bërë prej tij drejtuar subjektit Petrit Çomo, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, i është ankuar për procedura administrative që nuk janë ndjekur konform rregullave nga administrata e gjykatës. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e titullarit të gjykatës, i ka kthyer përgjigje të argumentuar shtetasit V. Ç. në lidhje me pretendimet e tij.

Komisioni vëren se nuk ka *indicie* apo prova që ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore.

- **Denoncimi 3**, i shtetasit H. Sh., i cili ka depozituar dy denoncime, përkatësisht në datat 7.2.2018 dhe 4.4.2018. Ky shtetas ngre ankesa ndaj prefektit të Tiranës S. D., subjektit S. S. prokurore për një kallëzim të bërë prej tij për grabitjen e pronës dhe gjithashtu ngre ankesa ndaj gjykatës penale, e cila nuk mori parasysh kërkesën për kundërshtim të vendimit të pushimit nga ana e prokurorisë. Ankuesi ka bashkëngjitur vendimin e prokurorisë së datës 21.10.2015, e cila ka vendosur pushimin e procedimit penal për kallëzimin e bërë nga ankuesi, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale. Ai ka bashkëngjitur edhe vendimin e gjykatës penale nr. *** akti, datë 15.2.2017, ku rezulton se ky vendim është dhënë nga subjekti Petrit Çomo, i cili, në cilësinë e gjyqtarit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit H. Sh. për kundërshtimin e prokurorisë, pasi ankuesi e ka zgjidhur këtë çështje nga ana civile më parë dhe nëse pretendon se i është shkelur ndonjë e drejtë tjetër, ai mund të ngrejë një tjetër padi.

Komisioni vëren se pretendimet e denoncuesit janë të natyrës civile që ai i ka zgjidhur me një proces gjyqësor civil të mëparshëm dhe se nuk ka *indicie* apo prova për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore.

- **Denoncimi 4**, datë 1.8.2018, i shtetasit R. N., i cili ankohet ndaj subjektit Petrit Çomo, me pretendimin se gjatë një procesi gjyqësor gjyqtari i çështjes (subjekti Petrit Çomo), në mënyrë

të paligjshme i ka rrëzuar kërkesat e bëra prej tij dhe avokatit të tij mbrojtës në lidhje me një akt ekspertimi.

Komisioni, pasi verifikoi pretendimet e ankuesit, vëren se vendimmarrja e subjektit është e bazuar në prova dhe fakte. Rrëzimi i kërkesave të të pandehurit (denoncuesit R. N.) nga ana e gjykatës janë të drejta, pasi fajësia e tij është vërtetuar me prova të plota gjatë gjykimit dhe kërkesat e njëpasnjëshme të denoncuesit kanë qenë përpjeke të tij për të vështirësuar procesin gjyqësor me kërkesa në dukje abuzive dhe të pabaza me qëllim shmangien e dënimit të tij. Kjo është pasqyruar qartë edhe në faktin e përjashtimit të gjyqtares së mëparshme që ka pasur në gjykim këtë proces, e cila u përjashtua në fazën e konkluzioneve përfundimtare, pasi i pandehuri ka kuptuar që çështja ishte në disfavor të tij.

Komisioni arrin në përfundimin se nuk ka prova apo *indicie* për të ngarkuar me përgjegjësi disiplinore subjektin.

- **Denoncimi 5**, datë 25.4.2018, i shtetasve F. A. dhe Sh. A., të cilët ngrenë ankesa ndaj disa subjekteve, duke përfshirë edhe subjektin Petrit Çomo, me pretendimin se subjekti zhvilloi dhjetëra seanca në lidhje me kallëzimin e bërë nga dy denoncuesit për mjekim të pakujdesshëm ndaj dy mjekëve, ku si pasojë e një ndërhyrjeje kirurgjikale humbi jetën djali i tyre dhe gjykoj një dosje të falsifikuar dhe të manipuluar nga prokurori i çështjes K. H., për të cilin kanë bërë kallëzim për falsifikim.

Komisioni vëren se denoncuesit nuk identifikojnë qartë se cili është objekti specifik i ankesës së tyre.

Komisioni vlerëson se nisur nga vendimi i gjykatës ankesa e tyre lidhet me vendimmarrjen e subjektit, pra me themelin e çështjes për të cilin Komisioni mban parasysht nenin 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”⁹⁸, për rrjedhojë, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi disiplinore subjekti i rivlerësimit.

- **Denoncimi 6**, me nr. *** prot., datë 23.1.2018, i shtetasit K. S., i cili ankohet ndaj subjekti Petrit Çomo dhe subjektit Y. P. (prokuror) për arsye se kanë dhënë vendim të padrejtë kundër tij. Nipi i tij P. D., i cili ka qenë palë në gjykim bashkë me të dhe me një shtetas tjetër L. C. ka pohuar se i ka dhënë nëpërmjet avokatit të tij shumën prej 250.000 lekësh dhe dyshon se këto para janë ndarë midis gjyqtarit dhe prokurorit, ndërsa ai vetë deklaroi se nuk ka asnjë faj dhe nuk ka paguar asnjë para, duke u dënuar me 8 muaj burg dhe çështja është në gjykatën e apelit. Denoncuesi ka bashkëngjitur edhe vendimin nr. ***, datë 8.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të pandehur shtetasit P. D., K. S. dhe L. C., të akuzuar për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 9.11.2016, ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit P. D. për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 e dënon përfundimisht të pandehurin P. D. me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim me një kohë prove prej dy vitesh... Deklarimin fajtor të të pandehurit K. S. për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/2 i*

⁹⁸ Neni 72/4 i ligjit nr. 96/2016 “...Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin me logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”.

Kodit Penal dhe dënimit e tij me 1 vit burgim. Në aplikim të nenit 406 e dënon përfundimisht të pandehurin P. D. me 8 muaj burgim.”

Komisioni, në lidhje me këtë denoncim, ka konstatuar se:

- a) Nga ana e gjykatës nuk është bërë i njëjti vlerësim, për sa i përket llojit dhe masës së dënimit njëlloj për të dy të pandehurit P. D. dhe K. S., për sa i përket rrethanave lehtësuese, pasi që të dy të pandehurit kishin kryer veprën penale, të parashikuar nga neni 182/2 i Kodit Penal dhe në bashkëpunim, referuar se:
- në cilin kriter është bazuar gjykata në lidhje me vlerësimin e rrezikshmërisë kur për të pandehurin P. D. gjykata ka vlerësuar rrezikshmëri të vogël shoqërore, ndërsa për të pandehurin K. S. ka vlerësuar me rrezikshmëri shoqërore, duke bërë diferencën;
 - nga ana e gjykatës nuk është vlerësuar fakti që i pandehuri P. D. ka deklaruar në prokurori se nuk e pranonte akuzën dhe sipas tij policën e sigurimit e kishte lëshuar L. C., ndërkohë që gjatë gjykimit ai e ka pranuar akuzën dhe ka treguar pendim të thellë, pra ka pasur deklarime të ndryshme nga L. C.;
 - për të pandehurin P. B. gjykata ka vlerësuar gjendjen ekonomike dhe familjare të të pandehurit dhe faktin se ky i pandehur është i vetmi person që punon në familje ndërkohë që ishte beqar, ndërsa për të pandehurin K. S. gjykata nuk ka marrë në konsideratë se ai ishte i martuar me dy fëmijë dhe se me çfarë të ardhurash do të jetonte familja e tij nëse për të do vendosej dënimi me burgim.
- b) Gjykata, për të dy të pandehurit që janë akuzuar për të njëjtën veprë penale dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duket se nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të rrethanave lehtësuese, që ka çuar në një vendimmarrje të ndryshme për të dy.

Pas kërkesës së Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pavarësisht se të dy personat akuzohen për të njëjtën veprë penale, dënimi është individual dhe ky është një nga parimet themelore të së drejtës. Në rastin konkret, i pandehuri P. D. ka pranuar akuzën dhe fajësinë dhe ka treguar pendim të thellë për veprën e kryer prej tij. Në këto kushte, ky i pandehur përfiton nga rrethana lehtësuese, parashikuar nga neni 48/ç i Kodit Penal. Gjithashtu, një i pandehur që pranon akuzën dhe fajësinë tregon pendim të thellë për veprën e kryer prej tij, nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ka rrezikshmëri shoqërore të ulët. Për sa i përket faktit që i pandehuri P. D. është cilësuar nga gjykata se është i vetmi që punon në familje, ky fakt rezultoi i vërtetë nga provat, pavarësisht se ai është beqar dhe jeton me prindërit. Gjithashtu, fakti se personi gjatë hetimeve paraprake nuk e ka pranuar akuzën, por këtë e ka bërë gjatë gjykimit, nuk është fakt që duhet vlerësuar nga gjykata në rrezikshmërinë shoqërore të tij. Provat merren gjatë gjykimit gjatë të cilit ai e ka pranuar akuzën dhe fajësinë. E kundërta, pra, nëse do ta kishte pranuar fajësinë gjatë hetimeve paraprake dhe nuk do ta pranonte në gjykim, do të vlerësohej nëse gjatë gjykimit do të vërtetohej fajësia e tij.

Për sa i përket të pandehurit K. S., ai nuk e ka pranuar akuzën dhe fajësinë as gjatë hetimeve paraprake dhe as gjatë gjykimit. Në rastin e këtij të pandehuri nuk kemi ndonjë rrethanë lehtësuese të parashikuar nga neni 48 i Kodit Penal. Për këtë shkak gjykata e ka konsideruar me rrezikshmëri shoqërore të zakonshme.

Në rastin konkret, gjykata ka marrë parasysh gjendjen familjare të të pandehurit, pasi për një veprë penale që dënohet me burgim nga 6 muaj në 4 vjet, e ka dënuar me 8 muaj burgim, pra, me një dënim relativisht të ulët, për më tepër kur ai nuk e ka pranuar akuzën dhe fajësinë dhe nuk ka pasur rrethana lehtësuese të parashikuara nga neni 48 i Kodit Penal.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota në lidhje me faktin se përse dy të pandehurit janë dënuar në mënyra të ndryshme, duke iu referuar nenit 48 të Kodit Penal.

Komisioni vëren se nuk ka *indicie* apo prova të depozituara nga denoncuesi që të provojnë marrjen e një vendimi nga subjekti si rrjedhojë e korrupsionit, për më tepër që Komisioni vlerëson se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë kryer shkelje në lidhje me këtë vendimmarrje, duke mos e ngarkuar me përgjegjësi disiplinore që mund të çonte deri në shkarkimin e tij nga detyra.

- **Denoncimi 7**, datë 30.4.2018 dhe datë 2.10.2018, i shtetas D. Xh., e cila ngre ankesa ndaj 11 subjekteve, përfshirë edhe subjektin Petrit Çomo në bashkëpunim të tyre si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal.

Denoncuesja i ka bashkëngjitur denoncimit edhe vendimin nr. *** akti, datë 12.1.2017, të gjykatës, ku subjekti Petrit Çomo ka qenë pjesë e trupit gjykues me dy gjyqtarë të tjerë. Ky vendim i referohet kërkesës së bërë nga denoncuesja D. Xh., me objekt “kundërshtimin e vendimit të prokurorisë datë 13.12.2016, për pushimin e procedimit penal të vitit 2016” ku denoncuesja ka kallëzuar një oficer të policisë gjyqësore për veprime arbitrare gjatë hetimit të çështjes së aksidentit të bashkëshortit të denoncueses.

Gjykata, me vendimin nr. *** akti, datë 12.1.2017, ka vendosur “*rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj*”, me arsyetimin se gjatë këtij procesi nuk mund të merren prova të reja nga gjykata. Nëse kallëzuesja disponon prova të reja ajo ka të drejtë t’i drejtohet prokurorisë dhe të bëjë kallëzim të ri sipas ligjit. Denoncuesja kërkon të kryhen disa veprime hetimore, ku gjykata çmon se ato janë pjesë e shqyrtimit gjyqësor me objekt “ankimin ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***”. Gjykata që po shqyrton këtë çështje do të shprehet mbi vlefshmërinë e veprimeve hetimore të kryera në këtë procedim penal, si dhe për faktin nëse hetimet janë të plota apo është e nevojshme të vazhdojnë.

Komisioni ka konstatuar se në vendimin gjyqësor nr. *** akti, datë 12.1.2017, ku subjekti ka qenë pjesë e trupës gjykuese, nuk gjejmë të shprehur qëndrimin e trupës gjykuese, referuar kërkesës së bërë nga ankesja D. Xh., për sa i përket moskryerjes nga ana e oficerit të policisë gjyqësore O. Gj., të veprimit hetimor të marrjes së pamjeve filmike nga kamerat në vendin ku ka ndodhur aksidenti.

Referuar konstatimit të mësipërm, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime.

Subjekti ka shpjeguar se pretendimet e kërkuases kanë pasur si objekt veprime apo mosveprime të kallëzuarit në lidhje me vepra të tjera penale, të parashikuara nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, çështje që nuk kanë të bëjnë me vendimin e prokurorisë që kundërshtohet përpara kësaj gjykate. Për më tepër, një çështje tjetër me objekt kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e kishte shfuqizuar vendimin e prokurorisë. Siç është shprehur dhe në vendim pretendimet e kërkuases nuk konsistojnë në akte korruptive të kallëzuarit (materiali nga SHÇBA-ja në prokurori ka ardhur për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal), po në cilësinë e punës se tij, kryesisht në moskryerjen e të gjitha veprimeve të ndryshme për zbardhjen e ngjarjes dhe në caktimin e ekspertit autoteknik në veprimet

e para hetimore, duke paracaktuar rezultatet e ekspertimit. Në rastin konkret gjykata ka gjykuar mbi veprimet e prokurorit në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe vendimi i prokurorisë është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj. Pavarësisht kësaj, kërkesja mund të ketë të drejtë në pretendimet e saj të cilat janë objekt shqyrtimi nga gjykata në një gjykim tjetër.

Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Në rastin konkret, vendimi i gjykatës ku subjekti i rivlerësimit është pjesë e trupit gjykues ka pasur për objekt vendimin e prokurorisë, i cili është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj nga gjykata. Ashtu siç subjekti është shprehur në vendim, pretendimet e kërkeses nuk konsistojnë në akte korruptive të të kallëzuarit (OPGJ-së), por në cilësinë e punës së tij, kryesisht në moskryerjen e të gjitha veprimeve të ndryshme për zbardhjen e ngjarjes dhe në caktimin e ekspertit autoteknik në veprimet hetimore.

Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie* apo prova që çojnë në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket anës profesionale.

V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreu IV dhe neni 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo:

- ka kryer deklaram të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor, të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal.

Nga analiza financiare, rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi tij nga trashëgimia dhe qiratë, ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016, në shumën -763,778 lekë, të cilën Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit, e vlerëson si të papërfillshme, duke mos prodhuar pasoja të tilla që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarami të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016;

- referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreu V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çomo, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreu VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se nga vlerësimi i secilit prej tri kritereve, subjekti i rivlerësimit:

- a. ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “a”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
- c. konsiderohet “i aftë” në vlerësimin e aftësive profesionale, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të pikës 1/a të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çomo, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komision e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 6.8.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Xhensila PINE
Anëtare (kundër)

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj